



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 111

Tiranë – E premte, 12 qershor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 10.6.2020	Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar..... 6267
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 10.6.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6267
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 169, datë 5.6.2020	Për zbatimin e protokolleve të operimit në transportin ajror, transportin rrugor dhe transportin detar, në kuadër të parandalimit dhe të kontrollit të pandemisë COVID-19..... 6275
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 94, datë 8.6.2020	Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020..... 6296

**AKT NORMATIV**
Nr. 25, datë 10.6.2020**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN**
NR.8952, DATË 10.10.2002, “PËR
LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK
TË SHTETASVE SHQIPTARË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Pas nenit 9/1, të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, shtohet neni 9/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 9/2
Dispozitë kalimtare

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve shqiptarë, që përfundon brenda vitit 2020, zgjatet deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 470, datë 10.6.2020**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA**
NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 5, 24, pika 1, e 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në tekstin e vendimit, emërtimet: “Ministria e Punëve të Jashtme” dhe “Britania e Madhe e Irlandës e Veriut/Britania e Madhe” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët: “... ministria përgjegjëse për punët e jashtme ...” dhe “... Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut ...”.

2. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titullin e këtij kreu, pas fjalës: “... vizë ...” shtohen fjalët: “... pullë ose elektronike ...”.

b) Pika 3, e seksionit A, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me vizë, si dhe tarifatat përkatëse të vizave përcaktohen në aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për të huajt që aplikojnë për vizë elektronike tipi “C” apo “D”, aplikohet një tarifë shtesë (fikse) për shërbimin, prej 20 (njëzet) eurosh, krahas tarifës së vizës të përcaktuar në aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Përjashtimi nga tarifat, përveç kur parashikohet ndryshe, mund të bëhet për arsye të justifikuara shtetërore, me kërkesë të autoritetit të institucionit shtetëror ose të ambasadorëve dhe



konsujve të përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe me miratimin e autoritetit përgjegjës në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme. Tarifat e vizave për të miturit nga moshë 6–12 vjeç janë sa gjysma e tarifave të vizave për të rriturit.”

c) Në pikën 4, fjalët: “... Tarifa për vizat nuk zbatohet për ...” zëvendësohen me: “... Tarifat nuk zbatohen për ...”.

ç) Pika 7 shfuqizohet.

d) Në titullin e seksionit B, fjalët: “... aplikuesi për vizë duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme ...” zëvendësohen me: “... aplikuesi për vizë duhet të paraqesë *on-line* dokumentet e mëposhtme ...”.

dh) Pika 1, e seksionit B, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Formularin e aplikimit për vizë, të plotësuar *on-line*, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

e) Aneksat nr. 2, 3 dhe 4, bashkëlidhur vendimit, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij kreu, zëvendësohen me anekset 2, 3 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin” shtohen fjalët: “... Rusi, Arabi Saudite, Bjellorusi, Katar, Oman, Tailandë, Bahrein, Indi me dokumentin pasaportë, për periudhën 10 qershor deri më 30 nëntor 2020.”.

II. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Aneks nr. 2

Listave e shteteve, shtetasit e huaj mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit që hyjnë pa vizë në Shqipëri

	Lista e shteteve që hyjnë në Shqipëri pa vizë, duke përdorur pasaportë diplomatike ose shërbimi	Diplomatike	Shërbimi
1	Afrika e Jugut	x	x
2	Algjeri	x	x
3	Egjipt	x	x
4	Ekuador	x	x
5	Indi	x	x
6	Indonezi	x	x
7	Jordani	x	x
8	Kuba	x	x
9	Marok	x	x
10	Mongoli	x	x
11	Rusi	x	x
12	Tailandë	x	x
13	Tunizi	x	
14	Vietnam	x	x



Aneksi nr. 3

Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe dokumenti që duhet të paraqesin

Nr.	Shteti	Me pasaportë	Me kartë identiteti
1	Andorra	x	
2	Argjentinë	x	
3	Armeni*	x	
4	Australi	x	x
5	Austri	x	x
6	Azerbajxhan*	x	
7	Belgjikë	x	x
8	Bosnjë dhe Hercegovinë	x	x
9	Brazil	x	
10	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	x	x
11	Bullgari	x	x
12	Danimarkë	x	x
13	Emiratet e Bashkuara Arabe*	x	
14	Estoni	x	x
15	Finlandë	x	x
16	Francë	x	x
17	Gjermani	x	x
18	Greqi	x	x
19	Holandë	x	x
20	Hong Kong, Kinë*	x	x
21	Hungari	x	x
22	Irlandë	x	x
23	Islandë	x	x
24	Itali	x	x
25	Izraeli	x	
26	Japoni	x	
27	Kanada	x	x
28	Kazakistan*	x	x
29	Kili	x	
30	Kosovë	x	x
31	Kroaci	x	x
32	Kuvajt*	x	



33	Letoni	x	x
34	Lihtenshtejn	x	x
35	Lituani	x	x
36	Luksemburg	x	x
37	Malajzi	x	
38	Mali i Zi	x	x
39	Maltë	x	x
40	Maqedoni e Veriut	x	x
41	Monako	x	x
42	Norvegji	x	x
43	Poloni	x	x
44	Portugali	x	x
45	Qipro	x	x
46	Rep. e Koresë (Jugu)	x	x
47	Republika Çeke	x	x
48	Republika Popullore e Kinës*	x	
49	Rumani	x	x
50	San Marino	x	x
51	Selia e Shenjtë	x	x
52	Serbia	x	x
53	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	x	x
54	Singapor	x	x
55	Slllovak	x	x
56	Sllloveni	x	x
57	Spanjë	x	x
58	Suedi	x	x
59	Tajvan, Kinë*	x	
60	Turqi*	x	
61	Ukrainë*	x	
62	Zelandë e Re	x	x
63	Zvicër	x	x



Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë, si rrjedhojë e hyrjes pa vizë në zonën Shengen

1	Antigua dhe Barbuda*	x
2	Bahamas*	x
3	Barbado*	x
4	Brunei*	x
5	Guatemalë*	x
6	Gjeorgji*	x
7	Honduras*	x
8	Kolumbi*	x
9	Kosta Rika*	x
10	Macao, Kinë*	x
10	Mauritius*	x
12	Meksikë*	x
13	Moldavi*	x
14	Nikaragua*	x
15	Panama*	x
16	Paraguai*	x
17	Peru*	x
18	Salvador*	x
19	Seychelles*	x
20	St. Kitts and Nevis*	x
21	Trinidad dhe Tabako*	x
22	Uruguai*	x
23	Venezuelë*	x

* Shtetasit e shteteve të shënuara me simbolin (*), për të qëndruar më shumë se 90 ditë në 180 ditë duhet të pajisen me vizë të tipit “D”, me qëllim aplikimin për leje qëndrimi.



Aneksi 4

Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë

	SHTETET QË HYJNË ME VIZË		VIZA “C”			VIZA “D”
Nr.	Shteti	Përfaqësia ku mund të aplikohet	Kosto 1-hyrje	Kosto 2-hyrje	Kosto shumë hyrje	Kosto
1	Afganistan	Ankara, Stamboll	€ 45,00	€ 45,00	€ 45,00	€ 45,00
2	Afrika e Jugut	Romë, Londër	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
3	Algjeria	Paris	gratis	gratis	gratis	gratis
4	Angola	Romë	€ 50,00	€ 75,00	€ 100,00	€ 100,00
5	Antigua dhe Barbuda	Londër	----	----	----	€ 35,00
6	Arabi Saudite	Riad	€ 54,00	€ 54,00	€ 54,00	€ 54,00
7	Armenia	Ankara, Moskë	----	----	----	€ 40,00
8	Azerbajxhan	Ankara, Moskë	----	----	----	€ 40,00
9	Bahamas	Londër	----	----	----	€ 35,00
10	Bahrein	Riad, Doha	€ 60,00	€ 60,00	€ 60,00	€ 60,00
11	Bangladesh	Pekin	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
12	Barbados	Londër	----	----	----	€ 25,00
13	Belize	Londër	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
14	Benin	Paris	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
15	Bjellorusi	Moskë, Varshavë	€ 50,00	€ 70,00	€ 100,00	€ 100,00
16	Bolivi	Brazilia	€ 30,00	€ 30,00	€ 50,00	€ 50,00
17	Botsvanë	Paris	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
18	Bregu i Fildishtë	Londër	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
19	Brunei	Romë, Riad	----	----	----	€ 25,00
20	Burkina Faso	Romë	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
21	Egjipt	Kajro	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
22	Ekuador	Brazilia	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00
23	Emiratet e Bashkuara Arabe	Abu Dhabi	—	—	—	€ 25,00
24	Eritre	Kajro	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
25	Etiopi	Kajro	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
26	Filipine	Pekin	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
27	Gabon	Kajro, Romë	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
28	Gana	Kajro, Romë	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
29	Guajanë	Brazilia, Romë	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00



30	Guatemalë	Brazilia	----	-----	----	€ 25,00
31	Guineja	Kajro, Stamboll	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
32	Gjeorgji	Ankara, Stamboll	---	---	---	€ 40,00
33	Haiti	Brazilia, Nju-Jork	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
34	Honduras	Brazilia, Nju-Jork	----	----	----	€ 30,00
35	Hong Kong, Kinë	Pekin	----	----	----	€ 35,00
36	Indi	Pekin, Abu Dhabi, Stamboll	€ 15,00	€ 15,00	€ 15,00	€ 15,00
37	Indonezi	Pekin	€ 33,00	€ 33,00	€ 33,00	€ 33,00
38	Irak	Ankara, Stamboll	€ 71,00	€ 71,00	€ 71,00	€ 71,00
39	Iran	Ankara, Stamboll	gratis	gratis	gratis	gratis
40	Ishujt Fixhi	Londër, Tokio	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
41	Jemen	Riad, Abu Dhabi	€ 20,00	€ 70,00	€ 70,00	€ 70,00
42	Jordani	Kajro	€ 23,00	€ 23,00	€ 23,00	€ 23,00
43	Kamboxhia	Pekin	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
44	Kamerun	Kajro	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
45	Katar	Doha	€ 20,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
46	Kazakistan	Ankara, Moskë	-----	-----	-----	€ 100,00
47	Kenia	Kajro	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
48	Republika Popullore e Kinës	Pekin	---	---	---	Gratis
49	Kirgistan	Ankara, Moskë	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
50	Kolumbi	Brazilia	---	---	---	€ 45,00
51	Kongo	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
52	Kore, Republika Popullore	Pekin, Sofje	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00
53	Kosta Rika	Brazilia	----	----	----	€ 30,00
54	Kubë	Brazilia, Sofje	€ 30,00	€ 30,00	€ 65,00	€ 65,00
55	Kuvajt	Kuvajt	---	---	---	€ 25,00
56	Lesoto	Kajro, Stamboll	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
57	Libani	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 50,00	€ 50,00
58	Liberi	Bukuresht	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
59	Libi	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
60	Madagaskar	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
61	Makao, Kinë	Pekin	----	----	----	€ 35,00
62	Malavi	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
63	Maldives	Londër	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
64	Mali	Romë	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
65	Marok	Bukuresht, Paris	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00



66	Mauritani	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
67	Mauritius	Londër	-----	-----	-----	€ 25,00
68	Meksikë	Romë	-----	-----	-----	€ 30,00
69	Moldavi	Bukuresht, Sofje, Ankara, Stamboll	---	---	---	€ 100,00
70	Mongoli	Moskë, Pekin	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
71	Mozambik	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
72	Namibi	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
73	Nepal	Pekin	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
74	Nigeri	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
75	Nikaragua	Romë	-----	-----	-----	€ 30,00
76	Oman	Riad, Abu Dhabi	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
77	Pakistan	Kajro, Stamboll	€ 20,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
78	Palestinë	Ankara, Kajro, Stamboll	gratis	gratis	gratis	gratis
79	Panama	Romë	-----	-----	-----	€ 100,00
80	Paraguai	Brazilia	-----	-----	-----	€ 50,00
81	Peru	Brazilia, Madrid	---	---	---	€ 60,00
82	Republika Dominikane	Brazilia, Nju-Jork	€ 40,00	€ 50,00	€ 70,00	€ 70,00
83	Ruanda	Kajro, Stamboll	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
84	Rusi	Moskë	€ 30,00	€ 50,00	€ 50,00	€ 50,00
85	Salvador	Londër	-----	-----	-----	€ 20,00
86	Sao Tome dhePrincipe	Londër	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
87	Senegal	Kajro, Stamboll, Paris	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
88	Seychelles	Kajro	---	---	---	€ 35,00
89	Sierra Leone	Kajro, Stamboll	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
90	Siri	Kajro, Stamboll	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
91	Somali	Kajro, Riad	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
92	Sri Lanka	Pekin	€ 6,00	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00
93	Sudan	Kajro	€ 62,00	€ 62,00	€ 62,00	€ 62,00
94	Suriname	Brazilia	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
95	St. Kitts and Nevis	Tokio, Londër	-----	-----	-----	€ 35,00
96	Tailandë	Pekin	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
97	Tanzani	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
98	Taxhikistan	Ankara, Moskë	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
99	Togo	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
100	Trinidad dhe Tabako	Londër	---	---	---	€ 20,00



101	Tunizi	Kajro, Stamboll	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00
102	Turkmenistan	Ankara, Stamboll, Moskë	€ 30,00	€ 50,00	€ 60,00	€ 60,00
103	Turqi	Ankara, Stamboll	-----	-----	-----	€ 35,00
104	Ugandë	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
105	Ukrainë	Varshavë, Shkup	----	---	---	85USD
106	Uruguai	Brazilia, Romë	----	----	-----	€ 30,00
107	Uzbekistan	Stamboll, Moskë	€ 30,00	€ 50,00	€ 100,00	€ 100,00
108	Venezuelë	Brazilia, Romë	-----	-----	-----	€ 30,00
109	Vietnam	Pekin	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
110	Xhamajkë	Londër, Nju-Jork	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
111	Zambia	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
112	Zimbabve	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
113	Të tjera	Në Amb. RSH më të afërt.	Reciprocitet Në mungesë € 35,00	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00

URDHËR**Nr. 169, datë 5.6.2020**

**PËR ZBATIMIN E PROTOKOLLEVE TË
OPERIMIT NË TRANSPORTIN AJROR,
TRANSPORTIN RRUGOR DHE
TRANSPORTIN DETAR, NË KUADËR
TË PARANDALIMIT DHE TË
KONTROLLIT TË PANDEMISË
COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për Marrjen e Masave të Veçanta Administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e protokolleve të operimit në transportin ajror, transportin rrugor dhe transportin detar, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të parandalimit dhe të kontrollit të pandemisë

COVID-19, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe Autoritetet portuale, për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**PROTOKOLLET E OPERIMIT
NË TRANSPORTIN AJROR, TRANSPORTIN
RRUGOR DHE TRANSPORTIN DETAR, NË
KUADËR TË PARANDALIMIT DHE TË
KONTROLLIT TË PANDEMISË COVID-19**

Protokollet e operimit në transportin ajror, transportin rrugor dhe transportin detar, mundësojnë vendosjen e masave proporcionale dhe efektive, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit dhe pasagjerëve, duke zvogëluar rrezikun e transmetimit SARSCoV-2 sa më shumë që të jetë e mundur.



A. MENAXHIMI I OPERIMEVE NË TRANSPORTIN AJROR

i. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbikëqyrë zbatimin e këtij protokoll nga Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë që fluturojnë për dhe nga Shqipëria, si dhe do të koordinojë me Institutin e Shëndetit Publik dhe Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për të lehtësuar zbatimin.

ii. Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë do të marrin masa për zbatimin e parashikimeve të këtij protokoll dhe do të koordinojnë me Autoritetin e Aviacionit Civil si Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës për masat në fjalë, me qëllim të arritjes së një mitigimi optimal të riskut. Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë do të monitorojnë efektivitetin e masave të marra dhe do të mbledhin të dhëna, të cilat do t'ia transmetojnë Autoritetit të Aviacionit Civil mbi baza javore.

iii. Materiale promovuese të sigurisë së shëndetit duhet të jenë gjerësisht të disponueshme në aeroport (hyrje, ekranet informuese, portat etj.). Materialet duhet të jenë të disponueshme në anglisht dhe në shqip. Këto materiale duhet të jenë të disponueshme edhe në kabinën e fluturimit, mundësisht me audio dhe me video dhe kur nuk është e mundur me fletëpalosje në xhepat e ndenjëseve të avionit (aneksi 2 i këtij protokoll).

iv. Enti Menaxhues i Aeroportit, në përputhje me Planin e tij të Emergjencave, duhet të caktojë një koordinator për të garantuar zbatim të masave parandaluese në mënyrë uniforme nga të gjitha subjektet që ofrojnë shërbime në aeroport.

1. MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË ÇDO KOHË:

1. Pasagjerët duhet të mbajnë distancën prej 1.5 metër në aeroport. Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë duhet të marrin masa për paralajmërimin e pasagjerëve për këtë rregull dhe vendosjen ku është e mundur të shenjave dalluese të distancimit fizik.

2. Pasagjerët dhe personat brenda aeroportit dhe avionëve duhet të mbajnë maska mjekësore të thjeshta, nga momenti që hyjnë në terminal në zonën e nisjeve deri sa dalin nga ndërtesa e terminalit, në aeroportin e destinacionit të tyre. Përgjatë kësaj rregull mund të bëhet kur nevojitet gjatë kontrollit të sigurisë në aviacion dhe atij të kufirit, për fëmijët nën 6 vjeç dhe personat që kanë arsye shëndetësore të dokumentuara

3. Maskat duhet të ndërrohen çdo 4 orë, nëse nuk këshillohet ndryshe nga prodhuesi, gjithashtu edhe kur lagen apo dëmtohen. Qese me një përdorim për hedhjen e maskave të përdorura duhet të jenë disponibël në bord të avionit dhe gjatë zbritjes.

4. Enti Menaxhues i Aeroportit nuk duhet të vendosë në aeroport kosha mbetjesh me prekje.

5. Procedura për përdorimin e maskave, heqjen e tyre dhe nxjerrjen jashtë përdorimit në mënyrën e duhur të maskave të përdorura, duhet të paraqitet nga ana e Entit Menaxhues të Aeroportit dhe operatorit ajror në materialet promovuese të sigurisë së shëndetit.

5.1 Përdorimi i maskave të fytyrës është një masë plotësuese, ndërkohë që do të vijojnë të zbatohen masat parandaluese të distancimit social, etikës respiratore, prekjës së fytyrës dhe higjienës së duarve.

6. Enti Menaxhues i Aeroportit, operatorët ajrorë dhe ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë setin standard në këtë rast të Mjeteve të Mbrojtjes Personale (MMP), për anëtarët e stafeve të tyre dhe të trajnojnë stafin për përdorimin përkatës.

7. Stafit që vepron me pasagjerët drejtpërdrejt duhet të veshë maskën mjekësore të thjeshtë ose prej cope, doreza dhe uniforme; uniformat duhet të ndërrohen çdo ditë dhe kur nuk mund të ndërrohen çdo ditë, do të përdoren kostume mbrojtëse. Agjentët e sigurisë që bëjnë kontroll fizik duhet të vendosin mbrojtëse xhami (*plexiglass*) në fytyrë krahas maskave.

8. Stafit që ndërvepron me pasagjerët në sportel, nëpërmjet një mbrojtësi të fortë ndarës (*plexiglass*) nuk është i detyruar të veshë MMP gjatë gjithë kohës. Këto struktura ndarëse duhet të kenë hapësirën e nevojshme të hapur për dorëzim të dokumenteve dhe pasagjerët, përveçse kur dorëzojnë dokumentet ose bagazhin, duhet të mbajnë distancë nga sporteli. Kjo duhet të udhëzohet nga Enti Menaxhues i Aeroportit, me shënime specifike në dysheme, të cilat do të zgjaten në të gjithë radhën, për të mundësuar mbajtjen e distancës fizike (prej 1,5 m).

9. Pasagjerët do të udhëzohen rregullisht për zbatimin e masave parandaluese nëpërmjet mesazheve vizuale dhe audio, si dhe me mjete të tjera, në aeroport dhe në bord të avionit. Pasagjerët duhet të udhëzohen nga Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë edhe për pasojat e moszbatimit të masave parandaluese.



9.1 Pasagjerët që nuk zbatojnë masat parandaluese:

a) Nuk do t'u jepet akses në ndërtesën e terminalit të aeroportit, në kabinë ose do të zbriten nga avioni, në rastet kur ngjarja ndodh përpara se të mbyllën dyert e avionit dhe do të largohen nga aeroporti nga autoritetet e rendit publik. Refuzimi nga ana e pasagjerit para nisjes së fluturimit, për të zbatuar masat mbrojtëse parandaluese në fuqi do të konsiderohet rast i justifikuar për moslejimin e vazhdimin të fluturimit për pasagjerin, që me gjithë paralajmërimet e përsëritura nuk pranon t'i zbatojë ato.

b) Koordinatori i caktuar nga Enti Menaxhues i Aeroportit, sipas këtij protokoll, sapo të sinjalizohet për një rast të moszbatimit të masave parandaluese do të njoftojë autoritetet kompetente për rendin publik në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

c) Nëse ngjarja ndodh gjatë fluturimit, do të zbatohen procedurat e trajtimit të pasagjerëve të parregullt dhe masa të mëtijshme për vënien në rrezik të sigurisë së operimit dhe sigurisë së shëndetit të pasagjerëve të tjerë dhe anëtarëve të ekuipazhit mund të ndërmerren nga autoritete lokale në aeroportin e destinacionit, sipas kërkesave kombëtare përkatëse.

PËRPARA MBËRRITJES NË AEROPORT

1. Pasagjerët që shfaqin simptoma të COVID-19 nuk do të lejohen të udhëtojnë nëpërmjet ajrit.

2. Operatorët ajrorë në bashkëpunim me Entin Menaxhues të Aeroportit duhet të informojnë pasagjerët e ardhshëm nëpërmjet masave promovuese, për kufizimin e udhëtimit për pasagjerët që mund të kenë simptomat e COVID-19, përpara mbërritjes në aeroportin e tyre të nisjes. Masat promovuese duhet të përfshijnë edhe simptomat për t'u konsideruar.

3. Pasagjerët në aeroport, që identifikohen simptomatik nga autoritetet e shëndetit publik, mund të mos lejohen të vazhdojnë udhëtimin. Operatorët duhet të kujtojnë herë pas here pasagjerët mbi këtë rregull.

4. Operatorët ajrorë dhe të aeroportit duhet të informojnë pasagjerët për detyrimin për veshjen e maskës mbrojtëse në aeroport dhe në avion, përveçse kur specifikohet ndryshe, në rast të kontroleve të sigurisë dhe kufirit. Gjithashtu, ata duhet të informojnë pasagjerët për kohëzgjatjen e pritshme të realizimit të masave parandaluese, për

një llogaritje të mbërritjes së tyre në aeroport në kohë. Koha që pasagjerët duhet të kalojnë në aeroport duhet të jetë sa më e shkurtër.

5. Aksesit në terminalin e aeroportit lejohet vetëm për pasagjerët, anëtarët e ekuipazhit dhe stafin e aeroportit. Shoqëruesve duhet t'i jepet akses vetëm në rrethana të veçanta (kur shoqërojnë minoren apo personat me aftësi të kufizuara etj.).

6. Pasagjerët duhet të informohen nga operatori ajror dhe i aeroportit përpara fluturimit mbi faktin se aksesit në terminal lejohet vetëm për pasagjerët, me përjashtim të rasteve të përmendura me sipër.

7. Përpara mbërritjes në aeroport, jo më afër se 24 orë përpara fluturimit, pasagjerët duhet të njihen me informacionin mbi simptomat e COVID-19 dhe risqet e kontakteve të mundshme me rastet e COVID-19 dhe duhet të firmosin (njihet edhe pranimi elektronikisht) njohjen e këtij informacioni, sipas deklaratës bashkëlidhur këtij protokoll (aneksi 1).

8. Operatorët e avionit duhet të bëjnë një deklaratë të ngjashme për ekuipazhin nën programin e tyre monitorues. Në rast dyshimi për simptoma apo çështje të lidhura me shëndetin, anëtari i ekuipazhit do të lëvizet menjëherë nga detyrat e fluturimit, pa shkaktuar presion apo frikë për masa ndëshkuese.

MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË AEROPORTIN E NISJES

PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI

1. Për të zvogëluar rrezikun e rënies në kontakt të pasagjerëve dhe të punonjësve me virusin COVID-19 gjatë qëndrimit në aeroport, aeroporti duhet të sigurojë higjienizimin dhe pastrimin, disa herë në ditë, të zonave të brendshme të aeroportit, me vëmendje veçanërisht në pikat ku përqendrimi i pasagjerëve është më i madh, siç janë, p.sh.: sportelet e *check-in*-it, kontrollet e sigurisë, portat e imbarkimit, sallat e kthimit të bagazheve, tualetet, duke përfshirë sistemet e kondicionimit, filtrat e ajrit, për të cilët duhet të rritet frekuenca e ndërrimit. Duhet të sigurohet, gjithashtu, edhe higjienizimi dhe pastrimi i zonave të jashtme tokësore, me referencë të veçantë për "kthesat / oborrin/sheshin e jashtëm", në pjesën e përparme të terminalit.

2. Higjienizimi dhe pastrimi duhet të bëhen duke përdorur personelin e caktuar dhe të trajnuar dhe produkte të përshtatshme, bazuar në udhëzimet e dhëna nga autoritetet shëndetësore për



të garantuar efektivitetin e ndërhyrjeve dhe duke marrë parasysh nevojën për të mos dëmtuar sipërfaqet ose sistemet e aeroportit dhe mjedisin.

3. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të caktojë procedura për të garantuar që pastrimi dhe dezinfektimi kryhet në mënyrë të vazhdueshme.

4. Nënkontraktorët dhe përdoruesit e hapësirave dhe të zyrave duhet të garantojnë, duke e vërtetuar që aplikojnë masat për higjienizimin dhe pastrimin e hapësirave dhe të sipërfaqeve, sipas mënyrave të njëjta të përshkruara më sipër.

5. Për një menaxhim efektiv të rrezikut të infektimit, ndërhyrjet e higjienizimit rekomandohen në të gjitha zonat e terminalit (p.sh.: zyrat, hapësirat operative, hapësirat tregtare) dhe automjetet e aeroportit të përdorura nga operatorët dhe pasagjerët.

6. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe eliminimit të shpejtë të grimcave më të lehta të çliruara në ajër nga njerëzit dhe që bien në tokë me shpejtësi më të reduktuar, Enti Menaxhues i Aeroportit, përpara rihapjes dhe gjatë funksionimit, duhet të bëjë kontrollat e duhura të sistemeve të ajrosjes: verifikimin e prurjeve të ajrit, ndërrimin e ajrit sipas numrit të njerëzve, matjen e cilësisë së ajrit. Më pas duhet të parashikohet, sa më shpejt që të jetë e mundur, verifikimi i përmirësimeve të mundshme të efikasitetit të impianteve, me instalimin e sistemeve të përhershme të matjes së cilësisë së ajrit, rritjen e shkëmbimeve të reja të ajrit, përmirësimin/fuqizimin dhe kalibrimin për rritjen e prurjeve të ajrit dhe krijimin e rrugëve të pastra të kalimit të ajrit në funksion të përdorimit të hapësirave, përmirësimin dhe/ose instalimin e pajisje të reja të sistemeve harduer dhe softuer për menaxhimin e ajrit. Këto ndërhyrje duhet të koordinohen me çdo rregullim të mundshëm funksional të hapësirave dhe të rrugëve të kalimit të destinuara për pasagjerët dhe ekuipazhet, për të luftuar përhapjen e virusit COVID-19.

7. Sistemi i ngrohjes, ajrosjes dhe kondicionimit të ajrit duhet të optimizohet për të garantuar nivel të lartë të ndërrimit të ajrit.

8. Operatorët ajrorë duhet të kryejnë pastrimin dhe dezinfektimin e avionit, sipas udhëzuesve për dezinfektimin dhe pastrimin, në fuqi.

9. Operatorët ajrorë duhet të përdorin lëndë të përshtatshme për përdorim në aviacion, pas çdo fluturimi që vjen nga një aeroport i vendosur në një

zonë me rrezik të lartë të transmetimit të infeksionit COVID-19.

Të tilla janë ato substance që përmbajnë alkool etanol 62%–71%, peroksid hidrogjeni 0,5% ose 0,1% hipoklorit i natriumit. Përshtatshmëria e ledeve duhet të kontrollohet sipas dokumenteve të prodhuesit të avionit.

10. Operatori ajror duhet të sigurojë në avion një ose më shumë Komplete Parandaluese Universale (KPU). Këto komplete duhet të përdoren për të mbrojtur anëtarët e ekuipazhit të cilët janë duke ndihmuar raste të dyshuara të COVID-19 dhe në pastrimin dhe heqjen e duhur të çdo përmbajtje potencialisht infektive.

11. Ekuipazhi i pastrimit duhet:

1.1 Të përdorë mjete të ndryshme pastrimi në zona të ndryshme, duke përdorur mundësisht kodimin me ngjyrë, në mënyrë që të zvogëlohet kontaminimi ndërmjet zonave.

1.2 Të shmangë dëmtimin e pjesëve dhe të përbërësve të avionit me dezinfektuesit;

1.3 Të spërkasë dyshtemenë në drejtim nga fillimi në fund, përpara dezinfektimit dhe më pas të spërkasë përsëri në drejtim të kundërt.

1.4 Të dezinfektojë zonat kryesore, siç është specifikuar më poshtë, duke filluar nga lartë poshtë, duke punuar në mënyrë progresive nga zona të pastra në ato të ndotura:

1.4.1 Korridor: Tavanet, koshat e sipërm, dritat e leximit, daljet e ajrit, panelet anësore, dritaret, vendet (tavolinat e tabakatë, armaturat, njësitë e kontrollit të pasagjerëve dhe panelet dekorative), dollapët/dollapët me kyç, raftet e revistave, kabinën, ulëset e stjuardesave.

1.4.2 Tualet: Dezinfektimi në tualet duhet të fillojë nga zona të ndotura drejt atyre të pastra, si më poshtë: tualeti, koshat e mbeturinave, lavamani, muret e lavamanit, tavani, dyert (sipërfaqet, dorezat e dyerve, çelësi i derës etj.)

1.4.3 Kuzhina: Tavani, furrat, kaldaja me ujë, prodhuesit e kafesë, ambientet, dollapët/dollapët me kyç, koshat e mbeturinave.

1.4.4 Kabina e pilotit:

1.4.5 Për avionët ku kabina e pilotit është e ndarë nga kabina e pasagjerit, dezinfektimi parandalues duhet të konsiderohet vetëm kur ekuipazhi i fluturimit ka pasur një ndalesë më të gjatë, duke rezultuar në ekuipazh që del jashtë zonës së kufizuar të aeroportit (p.sh., udhëtimi në hotel për një periudhë pushimi) në zonat me rrezik të lartë. Përndryshe kabina duhet t'i nënshtrohet pastrimit rutinë.



1.4.6 Për avionët ku ndarja e fortë midis kabinës së pilotit dhe kabinës së pasagjerëve nuk është e disponueshme frekuenca e dezinfektimit parandalues të kabinës së pilotit duhet të jetë e njëjtë me zonën e pasagjerëve.

2. AKSESI NË AEROPORT

1. Vajtje-ardhja në aeroport kryhet vetëm me automjet ose me taksi dhe sipas rregullave të përcaktuara për numrin e personave të lejuar në një automjet, përjashtuar rastet kur personat janë nga një familje, fëmijët e mitur dhe personat me aftësi të kufizuara. Automjeti privat parkohet ose nëse ardhja kryhet me shoqërues, ky i fundit vetëm le pasagjerët dhe largohet.

2. Vajtje-ardhja e stafit të punësuar apo e personave të tjerë, si staf i shoqërive ajrore, punëtorë, staf i zyrave të tjera etj. kryhet me automjet, me taksi, si dhe me autobus/ mikrobus/ furgon, i cili dezinfektohet dhe lahet përditë. Ulja në këto mjete kryhet duke lënë një hapësirë bosh në radhë dhe vetëm me një person në secilin rresht. Autobusët dezinfektohen/lahen përditë, sidomos ndenjëset dhe sipërfaqet e prekura. (Ky proces evidentohet sipas rregullave të brendshme të entit që i disponon dhe sipas rekomandimeve të mundshme nga DPSHTRR-ja dhe ISHP-ja.)

3. Të gjithë personat pasagjerë apo staf i punësuar detyrimisht mbajnë maskën veshur në rrugën vajtje-ardhje për në apo nga aeroporti.

3. MATJA E TEMPERATURËS NË AEROPORT

1. Hyrja e pasagjerëve kryhet vetëm nga një hyrje unike e përcaktuar. Në hyrjet e aeroportit ose në терминалет e pasagjerëve, në varësi të konfigurimit të aeroportit, mund të sistemohen zona të jashtme të përkohshme të mbuluara dhe/ose të pambuluara për menaxhimin e çdo radhe të mundshme që mund të krijohet, për shkak të operacioneve të matjes së temperaturës, verifikimeve, ekzaminimeve dhe/ose regjistrimit të pasagjerëve. Këto zona, gjithashtu, do të mund të përfshijnë tenda/strehë për mbrojtjen nga dielli dhe kushtet e këqija të motit.

2. Përpara hyrjes për në zonën *check-in* dhe lënies së bagazheve në godinën (terminalin) e aeroportit ngrihet një stacion ku nën monitorimin e personelit të specializuar matet temperatura e pasagjerit me termometër të kalibruar saktësisht, sipas një metode joinvazive të pranuar. Pasagjerët me temperaturë mbi 37.5 gradë celsius nuk lejohet të

vijojnë procedurën e *check-in*-it dhe ndaj tyre kryhen procedurat e tjera të verifikimit. Pasagjeri i cili kalon testin e temperaturës.

3. Hyrja e stafit të aeroportit kryhet vetëm nga një hyrje unike e përcaktuar (jo e njëjtë me pasagjerët). Përpara hyrjes ngrihet një stacion ku nën monitorimin e personelit të specializuar matet temperatura e personelit me termometër të kalibruar saktësisht. Personat me temperaturë mbi 38 gradë u nënshtrohen procedurave të tjera të verifikimit. Personat me temperaturë mbi 37.5 gradë celsius futen në zonën e veçantë të karantinimit.

4. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të garantojë kabina të ndryshme intervistimi për raste të dyshuara si potenciale, të cilat kërkojnë vlerësim të mëtejshëm. Këto kabina duhet të garantojnë konfidencialitetin dhe të parandalojnë transmetimin viral tek individët në kabinën ngjitur. Kabinat duhet të dezinfektohen pas çdo përdorimi.

5. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të sigurojë një mjedis me të gjitha kushtet higjieno-sanitare për izolimin e pacienteve brenda aeroportit.

4. DEKLARATA E COVID-19

Në përputhje me rregullat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, pasagjerët duhet të plotësojnë një deklaratë mbi statusin e tyre të COVID-19 përpara se të kenë një leje për të hipur në bord të avionit (*boarding pass*), gjatë procesit të *check-in* (deklarata në shtojcën 1 të këtij protokollit).

5. HYRJA NË GODINËN E AEROPORTIT DHE LËVIZJA E PASAGJERIT NË NISJE

1. Pas hyrjes në aeroport nga secila hyrje, qoftë për pasagjerë, qoftë për stafin, Enti Menaxhues i Aeroportit vë në dispozicion higjienizues për duart me produktin përkatës me përmbajtje mbi 70% alkool.

2. Enti Menaxhues i Aeroportit merr masa që në aeroport të krijohet mundësia e blerjes së maskave, në rast se pasagjerët nuk kanë maska personale.

3. Operatorët ajrorë, në koordinim me entin menaxhues të aeroportit, duhet të marrin masa që kontakti pasagjer-staf të kryhet përmes xhamit mbrojtës (*plexiglass*). Gjithashtu, vendosen shenjat e pritjes në radhë në distancë prej 1.5 metrash, si dhe distancë nga banaku prej 1 metri. Inkurajohet



kryerja e *check-in online* për të shmangur radhët dhe kontaktet fizike.

4. Pasagjerët duhet të inkurajohen nga operatorët ajrorë për të minimizuar bagazhin e dorës dhe kalimin e bagazheve në kompartimentin e kargos. Nuk lejohet mbajtja e baterive *lithium* në pajisje ose më vete në bagazhet e kontrolluara.

5. Në kontrollin e sigurisë, pasagjerët, presin në radhë, duke respektuar distancën prej 1.5 metrash. Për këtë arsye vendosen shenjat përkatëse (shirita me ngjyrë të dallueshme) të pritjes në radhë. Personeli i sigurisë përdor maskë dhe mbrojtëse me xham mbrojtës (*plexiglass*). Pas çdo kontrolli me prekje të objekteve kryhet higjienizimi i duarve. Gjatë kontrolleve të sigurisë, sugjerohet minimizimi i rasteve të kontrollit me duar (*hand search*), pa neglizhuar kërkesat e sigurisë së aviacionit. Në zonën e kontrollit vendoset detyrimisht produkti higjienizues i duarve.

6. Pas kalimit të kontrollit të sigurisë, duke ruajtur distancën prej 1.5 metrash pasagjeri i drejtohet kontrollit të pasaportës. Kabina e kontrollit pajiset me ndarëse të fortë mbrojtëse. Pasaporta, bileta, prokura për fëmijët apo çdo dokument tjetër shqyrtohen duke u vendosur fizikisht në xhamin mbrojtës, përmes të cilit lexohet nga punonjësi i policisë, duke shmangur pra sa më shumë prekjen e dokumenteve. Pas kryerjes së kontrollit pasagjeri dezinfekton duart me higjienizues në dalje nga kjo zonë. Higjienizuesi vendoset menjëherë pas daljes.

7. Në pritje në dalje (*gate*) për t'u nisur, duhet të shmangen grumbullimet e personave. Pritja duhet realizuar duke ruajtur distancën e sigurisë. Në stola lihet një vend bosh i lirë për të respektuar distancën. Imbarkimi në avion duhet të kryhet në këmbë dhe jo me autobus. Enti përfaqësues i aeroportit merr masa për krijimin e korsive të dedikuara të ecjes më këmbë dhe të pritjes jashtë avionit për futjen me radhë të pasagjerëve, duke garantuar distancën prej 1.5 metrash. Prioritet kanë personat e moshuar, personat në nevojë dhe familjet me fëmijë të mitur. Këta duhen sistemuar nga kompania ajrore në fillim të avionit. Ky sistemim kryhet përmes caktimit të vendeve prioritare në *check-in*.

8. Nëse nevoja kërkon imbarkimin nëpërmjet autobusit, duhet të rritet numri i autobusëve për të siguruar distancën e nevojshme fizike.

9. Enti menaxhues i aeroportit, në koordinim me operatorin e avionit dhe ofruesit e shërbimeve, do të vendosin në pjesën e fundit të platformës së shkallëve një shpërndarës automatik të dezinfektimit, ku pasagjerët mund të dezinfektojnë duart para se të hyjnë në avion, si dhe një platformë dezinfektimi me një tapet të njomur me dezinfektues, mbi të cilin pasagjerët duhet të shkelin.

6. MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË BORD TË AVIONIT

1. Stafi i punësuar mban në çdo moment maskat dhe dorezat veshur që nga ardhja në aeroport dhe deri në mbërritjen në aeroportin tjetër ku zbatohet masat e protokollit sipas secilit destinacion.

2. Pasagjeri do të informohet nga ekuipazhi i operatorit ajror, me materiale udhëzuese, në lidhje me zbatimin e masave parandaluese në bord të avionit që përfshijnë:

2.1 Higjienizimi i duarve, veçanërisht para ngrënies apo pirjes dhe para përdorimit të tualetit;

2.2 Përdorimi i maskës;

2.3 Etika respiratore;

2.4 Kufizimi i kontakteve me sipërfaqet e kabinës së avionit;

2.5 Kufizimi i kërkesave për shërbime në bord.

3. Në informimet që i jepen pasagjerit, duhet të përfshihet instruksioni për heqjen e maskave të fytyrës në rast të emergjencave dhe përpara përdorimit të maskës së oksigjenit. Po kështu edhe ekuipazhi informohet nga operatori i avionit që duhet të heqë maskën mbrojtëse, kur jep instruksione në rast emergjence.

4. Pavarësisht detyrimit të pasagjerit për të mbajtur maskë, operatori ajror duhet të garantojë furnizim të mjaftueshëm me maska në avion, veçanërisht për fluturime të gjata.

5. Nuk rekomandohet shërbimi i ushqimit apo i lëngjeve në bord. Në rast se do të shërbehen, mbetjet e tyre duhet të mblidhen sa më shpejt dhe të vendosen në vendgrumbullim të veçantë. Stafi shërben vetëm me doreza dhe maskë mbrojtëse.

6. Pasagjeri duhet të informohet lidhur me masat e aeroportit të shtetit ku do të mbërrijë. Ky informim kryhet në momentin e blerjes së biletës ose në bordin e avionit nëpërmjet audios, videos apo fletëpalosjeve të ilustruara me foto apo infografike të kuptueshme. Ndryshimet e momenteve të fundit duhet të komunikohen me



mjetet e përshtatshme më parë, në mënyrë që pasagjerët të marrin masat përkatëse.

7. Nuk do të lejohet *duty free* apo shitje të tjera në bord të avionit.

8. Tualetet e avionit duhet të dezinfektohen përpara çdo fluturimi. Përdorimi i shpeshtë i tyre duhet të reduktohet.

9. Operatorët ajrorë që përdorin riqarkullim të ajrit të kabinës ose do të instalojnë dhe do të përdorin filtrat HEPA (filtrat me efikasitet të lartë të ajrit të grimcuar), sipas specifikave të prodhuesit ose do të shmangin përdorimin e riqarkullimit të ajrit të kabinës tërësisht, me kusht që të konfirmohet se kjo nuk do të rrezikojë asnjë nga funksionet kritike të sigurisë në operim (p.sh., ftohja avionike, presioni i kabinës etj.). Kur instalohen filtrat HEPA, ventilatorët e riqarkullimit nuk duhet të ndalen, por rritja e rrjedhës së ajrit të freskët duhet të përdoret, duke zgjedhur paketën e lartë të nxjerrjes së ajrit, kurdo është e mundur.

10. Operatorët ajrorë duhet të rishikojnë procedurat e tyre për përdorimin e ventilatorëve të riqarkullimit të ajrit dhe sistemeve të kondicionimit, bazuar në informacionin e dhënë nga prodhuesi i avionit. Operatorët duhet të konfirmojnë praktikën e zgjedhjes së konfigurimit të paketave të rrjedhjes së lartë të ajrit, me prodhuesit e avionëve dhe të ndjekin ato udhëzime për përdorim të vazhdueshëm.

11. Operatorët ajrorë, në kuadër të zbatimit të masave parandaluese të distancimit social, përveç masave të tjera shëndetësore dhe higjienike, që duhet të respektohen në çdo kohë, kur lejohen nga ngarkesa e pasagjerëve, konfigurimi i kabinës dhe kërkesat për masën dhe ekuilibrin, duhet të sigurojnë, sa të jetë e mundur, distancën fizike midis pasagjerëve. Anëtarët e familjes dhe individët që udhëtojnë së bashku, si pjesë e së njëjtës familjeje mund të ulen pranë njëri-tjetrit. Procesi i ndarjes së vendeve duhet të modifikohet në përputhje me rrethanat.

12. Operatorët ajrorë dhe enti menaxhues i aeroportit duhet të marrin masa që pasagjerët të mos qëndrojnë në bord të avionit më gjatë se 30 minuta pa ventilimin e duhur.

13. Dalja nga avioni kryhet me radhë duke respektuar distancën.

7. MENAXHIMI I PASAGJERËVE ME SIMPTOMA NË BORD TË AVIONIT

Në rast se, pas ngritjes së avionit, një pasagjer dëshmon simptoma që përputhen me COVID-19, siç janë temperatura, kolla, të vjella, diarre, vështirësi në frymëmarrje apo simptoma të tjera gripi, ndaj tij do të merren masat e mëposhtme:

1. Ekuipazhi siguron që pasagjeri simptomatik ka vendosur siç duhet maskën dhe vë në dispozicion maska të tjera. Nëse pasagjeri ka vështirësi në frymëmarrje, duhet t'i ofrohet asistencë mjekësore dhe furnizim me oksigjen të shtuar.

1.1 Pasagjeri duhet të izohet në bord. Në varësi të konfigurimit të avionit dhe disponueshmërisë së rastit, pozicionin e rastit simptomatik dhe për aq sa është e mundur duhet të caktohet një zonë izolimi, duke lënë për aq sa është e mundur 2 radhë me ndenjës të lira, rreth çdo drejtimi të pasagjerit të dyshuar;

1.2 Aty ku është e mundur tualeti më pranë pasagjerit të dyshimtë duhet të dedikohet specifikisht për të dhe nuk duhet të përdoret nga pasagjerët e tjerë dhe ekuipazhi;

1.3 Sipas përbërjes së ekuipazhit të kabinës, anëtarë më i lartë i ekuipazhit të kabinës designon anëtarë të caktuar të ekuipazhit për të ofruar shërbime në fluturim në zonën e izoluar. Këta anëtarë duhet të jenë ata që kishin kontakt me pasagjerin e dyshuar dhe duhet të përdorin MMP nga Komploti Parandalues Universal i avionit. Ekuipazhi i dedikuar duhet të minimizojë kontaktin me pjesën tjetër të ekuipazhit dhe pasagjerët e tjerë.

2. Aty ku është e mundur, valvula individuale e ajrit për pasagjerin simptomatik duhet të mbyllet;

3. Nëse pasagjeri i dyshuar udhëton i shoqëruar, shoqëruesi duhet të vendoset në zonën e izoluar edhe pse nuk shfaq simptoma.

4. Ekuipazhi duhet të njoftojë aeroportin e destinacionit, nëpërmjet sistemit të kontrollit të trafikut ajror, të ndjekë udhëzimet e tyre dhe të plotësojë pjesën shëndetësore të deklaratës së përgjithshme të avionit për të regjistruar informacionin shëndetësor në bord dhe ta dorëzojë në autoritetet shëndetësore të pikës së hyrjes.

5. Pasi avioni është ulur dhe pasagjerët e tjerë janë zbritur nga avioni, pasagjeri i izoluar dhe kur kërkohet, anëtarët e ekuipazhit do të transferohen, sipas udhëzimeve të autoriteteve lokale të shëndetit.



6. Pasagjerët e ulur gjatë së njëjtës radhë apo deri në dy radhë më larg rastit të dyshuar, si dhe kushdo që ka pasur kontakt me të gjatë udhëtimit mund të konsiderohen kontakte të afërta dhe do të intervistohen dhe do të ndiqen nga ana epidemiologjike nga autoritete publike shëndetësore të vendit hyrës.

7. Operatori ajror duhet të marrë informacion mbi rezultatin e testimit për rastin e dyshuar sa më shpejt të jetë e mundur.

8. Anëtarë i ekuipazhit që ofroi shërbimin në fluturim për rastin e dyshuar, konsiderohet kontakt i afërt dhe do të kryejë vetizolim pas kthimit në vendin e tij të origjinës, si dhe nuk do të shërbejë në rrugën e kthimit të linjës së udhëtimit ajror, duke respektuar të gjitha masat strikte të sigurisë.

9. Nëse rasti i dyshuar rezulton pozitiv, ekuipazhi përkatës do të vendoset në karantinë për 14 ditë. Nëse testi rezulton negativ, ata mund të rifillojnë detyrat në fluturim.

10. Pas largimit të rastit të dyshuar, pastrimi dhe dezinfektimi i avionit duhet të kryhet sipas instruksioneve në fuqi. MMP-të e përdorura duhet të vendosen në një qese mbetjesh të veçantë të mbyllur mirë, e cila mund të procedohet sipas udhëzuesve për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

11. Nëse një pasagjer i dyshuar identifikohet përpara ngritjes së avionit, aeroporti dhe mjeku përkatës i ISHSH-së, duhet të njoftohen nëpërmjet koordinitorit të caktuar, sipas këtij protokoll, dhe ndiqen instruksionet në fuqi. Nëse nuk ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë mes ekuipazhit dhe të dyshuarit, nuk ka nevojë të merren masa shtesë, në lidhje me menaxhimin e ekuipazhit, përveçse kur udhëzohet nga ISHSH-ja.

8. MENAXHIMI I PASAGJERËVE NË MBËRRITJE

1. Pasagjerët duhet të kujtohen nga operatori ajror mbi detyrimin për të mbajtur maskën dhe respektimin e distancës gjatë lëvizjes në këmbë.

2. Për pasagjerët në mbërritje, dalja nga avioni kryhet me radhë, duke respektuar distancën. Zbritja nga avioni bëhet me rreshta, duke filluar me rreshtin në korridor që është më pranë daljes së avionit, e duke vijuar me rreshtin që është në anën tjetër të korridorit, e më pas dalin me radhë karriget e mesit e në fund ato të dritares.

3. Lëvizja e tyre drejt pikës së kontrollit të pasaportave kryhet në këmbë. Nëse lëvizja kryhet

me autobus, numri i autobusëve duhet të shtohet, me qëllim garantimin e distancës fizike përkatëse. Përpara futjes në aeroport duhen dezinfektuar duart dhe më pas kalohet në tunelin *spray* me dezinfektant. Në pritje vendosen shenjat e ruajtjes së distancës.

4. Operatorët ajrorë do të japin për autoritetet e shëndetit publik, pa vonesë dhe pa shkelur rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat e mëposhtme:

- emrin e plotë;
- vendin e pasagjerit;
- numër telefoni ose adresë *email*-i.

5. Në zonën e mbërritjeve kryhet matja e temperaturës me termometër të kalibruar saktësisht, sipas një mënyre joinvazive të miratuar. Për të evituar dublikimin, pasagjerët që vijnë nga fluturime BE, të cilët u janë nënshtrua matjes së temperaturës në aeroportin e nisjes, do të përjashtohen nga kjo procedurë kur hyjnë në RSH.

6. Personat me temperaturë mbi 37.5 gradë nuk lejohet të hyjnë në aeroport dhe ndaj tyre kryhen procedurat e tjera të verifikimit. Personat me temperaturë mbi 37.5 gradë futen në zonën e veçantë të karantinimit.

7. Asnjë pasagjer simptomatik nuk duhet të riatdhesohet me një fluturim të rregullt pasagjerësh.

8. Pritja e bagazheve, si dhe kontrollat e mundshme doganore kryhen duke respektuar distancën e sigurisë prej 1.5 metrash. Nuk duhen lejuar grumbullimet e personave në daljen e bagazheve. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të mundësojë shpërndarjen e bagazheve sa më shpejt të jetë e mundur.

9. Me daljen nga zona e mbërritjeve, pasagjeri vijon me dezinfektimin e duarve përpara se të largohet nga ambientet e brendshme të aeroportit. Familjarët e pasagjerit dhe persona të tjerë (taksistë, staf) nuk lejohen në afërsi të daljes nga godina e aeroportit.

9. MENAXHIMI I EKUIPAZHIT

Anëtarët e ekuipazhit, anëtarët e stafit të aeroportit dhe anëtarët e ofrimit të shërbimeve duhet të përjashtohen nga procedurat e kontrollit të COVID-19, nëse operatorët ajrorë dhe enti menaxhues i aeroportit dëshmojnë se kanë në fuqi dhe zbatojnë një procedurë ekuivalente për të monitoruar gjendjen shëndetësore të stafit të tyre.

Enti menaxhues i aeroportit duhet të garantojë radhë të veçantë për ekuipazhin.



10. INFORMIMI

1. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19, sipas *check-listës* së miratuar dhe numrin jeshil për denoncim.

2. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19, sipas formatit të miratuar dhe numrin jeshil për denoncim.

3. Enti Menaxhues i aeroportit duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të aeroportit nga personat e punësuar/pasagjerët.

4. Enti Menaxhues i Aeroportit duhet të përgatisë materiale informuese ku do të përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/pasagjeri/çdo person tjetër palë e tretë që hyn e del në aeroport; mundësia e ndalimit të udhëtimit për pasagjerët me simptoma; detyrimi i pasagjerit për t'u paraqitur i pashoqëruar në aeroport; detyrimin për të zbatuar rregullat e distancimit fizik, atë të mbajtjes së maskës, të etikës respiratore, higjienës etj., përgjegjësia për personin apo subjektin juridik që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe këtij protokollit etj.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil mbikëqyr marrjen e masave nga Enti Menaxhues i Aeroportit dhe shoqëritë ajrore, sipas detyrimeve të këtij protokollit.

6. Materialet afishohen në hyrje-dalje të aeroportit, si dhe në vende të dukshme në brendësi të tij dhe bëhen publike me mjete të tjera alternative si website, pamje video etj.

7. Gjuha e përdorur do të jetë shqip dhe anglisht.

8. Operatorët ajrorë në momentin e blerjes së biletës i japin pasagjerit informacione mbi fluturimin dhe rregullat e sjelljes të diktuar nga emergjenca shëndetësore në proces dhe, më në veçanti, ato që kanë të bëjnë me kufizimet e udhëtimit për të gjithë pasagjerët që paraqesin simptoma të pajtueshme me COVID-19 para mbërritjes në aeroportin e nisjes. Kërkohej që Enti Menaxhues i Aeroportit dhe operatorët ajrorë të koordinohen mes tyre për të ofruar udhëzime unike për përdoruesit e tyre, në lidhje me përdorimin e saktë të aeroportit/terminalit të nisjes dhe të mbërritjes. Në kohën e riaktivizimit të operimeve në aeroport/terminal kërkohej një koordinim i fushatave ndërgjegjëse drejtuar pasagjerëve për përdorimin e transporti ajror në përputhshmëri të plotë me rregullat për parandalimin e përhapjes së virusit.

SHTOJCA 1

NJOFTIMI I GJENDJES SHËNDETËSORE PËRPARA LËSHIMIT TË LEJES SË KALIMIT NË BORD (BOARDING PASS)

Më poshtë paraqitet një format/ model "Njoftimi për gjendjen shëndetësore që duhet plotësuar përpara lëshimit të një lejeje kalimi bordi, individualisht nga çdo pasagjer."

Unë e kuptoj se duhet të njoftoj _____

(emrin e transportuesit ose agjentit)

sa më shpejt të jetë e mundur dhe se në asnjë rast nuk duhet të pretendoj për fluturimin, nëse gjendet e fshehur ndonjë nga deklaratimet e mëposhtme:

- ☐ Jam diagnostikuar me COVID-19 gjatë periudhës 14-ditore para fluturimit tim.
- ☐ Kam pasur simptoma të COVID-19 (ethe, kollë rishtas, humbje të shijes ose të nuhatjes, bllokim të fry marrjes) gjatë periudhës 8-ditore para fluturimit tim.
- ☐ Kam qene në kontakt të ngushtë (p.sh., më pak se 2 metra për më shumë se 15 minuta) me një person që ka pasur COVID-19 në periudhën 14-ditore para fluturimit tim.
- ☐ Më është kërkuar nga rregullat kombëtare ose vendore të karantinohen për arsye të lidhura me COVID-19 për një periudhë që përfshin datën e fluturimit.

Unë e kuptoj se ndonjë nga këto rrethana mund të çojë në refuzimin e nisjes së udhëtimit tim, nëse unë nuk e deklaroj këtë informacion për transportuesin dhe rrethanat e mia zbulohen në vend në aeroport.

Emri, mbiemri



SHTOJCA 2

PROMOVIMI I SIGURISË SË SHËNDETIT

Mesazh i përgjithshëm:

- Mbani maskat mjekësore të fytyrës, siguroni përdorimin e tyre korrekt dhe ndërrojeni çdo 4 orë (përveç kur instruksioni thotë ndryshe);
- Kujdesuni për distancimin fizik (1.5 metra);
- Lani duart rregullisht për së paku 20 sekonda me sapun dhe ujë ose kur nuk është mundur, përdorni alkool për dizinfektimin e duarve;
- Mbuloni gojën dhe hundët me shami/letër për hundët ose bërrylin e përkulur kur teshtini ose kolliteni;
- Ruani kontaktin direkt me sipërfaqet dhe me njerëzit;
- Tregoni kujdes për të tjerët – si një mënyrë për të mbrojtur ata.

Para largimit nga aeroporti:

- Plotësoni Pyetësin e Monitorimit të Shëndetit të dhënë nga transportuesi ajror;
- Mos udhëtoni për në aeroport nëse keni thënë po për ndonjë nga pyetjet e këtij pyetësi;
- Jini në dijeni se vetëm pasagjerët duhet të hyjnë në terminalin e aeroportit në nisje dhe mbërritje (të tjerë njerëz të lejuar të cilët mund të hyjnë në terminal janë ata që shoqërojnë ose marrin një pasagjer që kërkon asistencë - personat me aftësi të kufizuara lëvizjeje ose fëmijët e pashoqëruar);
- Lexoni materialin e promovimit të sigurisë shëndetësore nga transportuesi juaj ajror;
- Kontrolloni nëse keni mjaftueshëm maska mjekësore për fytyrën dhe xhel sanitar për udhëtimin tuaj;
- Sigurohuni të keni kohë të mjaftueshme për udhëtimin, duke përfshirë dhe kontrollet në aeroport.

Në aeroport:

- Kërkoni nga personeli sqarim, nëse keni ndonjë pyetje/dyshime ose ndieni vështirësi (ata janë aty t'ju ndihmojnë ju në situatën e re);
- Përgatituni për skanimin termal në aeroport;
- Bëni gati pyetësin e monitorimit të shëndetit (nëse nuk e keni elektronik, në celular);
- Vini re barrierat fizike ose shenjat që tregojnë distancën e nevojshme fizike;
- Kontrolloni bagazhin tuaj (*check-in*) kur mundesh;

- Minimizoni përdorimin e fasiliteve të aeroportit;

- Parashikoni mohimin e lejimit të hyrjes në bord nëse nuk e keni vënë maskën.

Në avion:

- Pyesni stjuardesën nëse keni ndonjë pyetje/dyshime ose ndieni vështirësi (ata janë aty t'ju ndihmojnë ju në situatën e re) dhe tregoni mirësjellje ndaj tyre.

- Ndiqni demonstrimin e sigurisë ajrore në kabinë, për t'u njohur se çfarë mund t'i ndodhë fluturimit tuaj

- Minimizoni përdorimin e valvulës individuale të ajrit, sa më shumë të jetë e mundur.

B. MENAXHIMI I OPERIMEVE NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE TË MALLRAVE

I. TRANSPORTI QYTETËS/URBAN I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

1. Në transportin qytetës të udhëtarëve me autobus do të lejohet udhëtimi me kapacitet të reduktuar, vetëm duke respektuar distancën prej 1 m midis udhëtarëve.

2. Udhëtarët duhet të jenë të pajisur me maska, doreza, si dhe të respektojnë distancën e sigurisë prej 1 m, nga e cila mund të përjashtohen udhëtarët, të cilët janë pjesë e së njëjtës familjeje, vërtetuar/provuar në bazë të dokumenteve të identifikimit.

3. Në stacionet e qëndrimit të respektohet masa e distancimit social prej 1 m.

4. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maskë mbrojtëse/doreza.

5. Mjetet e operimit do të dezinfektohen çdo ditë në ambientet e subjektit të licencuar nën monitorimin e bashkisë.

6. Mjetet e operimit në transportin qytetës/urban duhet të pajisen me dizinfektantë me bazë alkooli dhe me shenja sinjalizuese për qëndrimin e udhëtarëve, duke respektuar masën e distancimit social.

7. Në çdo mjet do të vendosen postera për respektimin e rregullave të higjienës të rekomanduara nga OBSH-ja, të vendosura në vende të dukshme për udhëtarët.

8. Gjatë udhëtimit duhet të bëhet e mundur ajrimi i ambienteve të brendshme të mjetit, duke mbajtur dritaret hapur, përgjatë gjithë kohës së udhëtimit.



9. Subjektet e licencuara duhet të sigurojnë respektimin e masave të higjienës, distancimit social dhe rregullat për hipjen/zbritjen e udhëtarëve.

10. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

II. TRANSPORTI NDËRQYTETËS I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

1. Numri i udhëtarëve që do të lejohen të udhëtojnë do të jetë 70% e kapacitetit të mjetit të përcaktuar në lejen e qarkullimit, duke respektuar distancën e sigurisë midis udhëtarëve.

2. Ulja e udhëtarëve do të jetë në mënyrë diagonale. Kjo rregull do të zbatohet për të gjithë udhëtarët, përveçse kur personat janë pjesë e të njëjtës familje, vërtetuar/provuar në bazë të dokumenteve të identifikimit.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska mbrojtëse, doreza dhe ka për detyrë të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Udhëtarët duhet detyrimisht të mbajnë maska mbrojtëse dhe doreza përgjatë gjithë udhëtimit.

5. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në dyer të ndryshme të mjetit, të parashikuara për këtë qëllim.

6. Nëse udhëtari shfaq simptoma të COVID-19, bazuar në rekomandimet e MSHMS-së, ISHP-së dhe OBSH-së, drejtuesi i mjetit duhet të lajmërojë Urgjencën Kombëtare në numrin e kontaktit 127 dhe të mos lejojë hipjen ose zbritjen e udhëtarin në stacionin më të afërt, kur simptomat shfaqen gjatë udhëtimit.

7. Shoqëria e transportit të licencuara, në nisje duhet të dezinfektojnë mjetin, bagazhet, si dhe të kenë dezinfektantë me bazë alkooli, jo më pak se 60% për t'u përdorur nga udhëtarët në momentin e hipjes.

8. Gjatë udhëtimit duhet të bëhet ajrimi i ambienteve të brendshme të mjetit, duke mbajtur dritaret hapur, përgjatë gjithë kohës së udhëtimit.

9. Në terminale dhe stacione duhet të zbatohet masa e distancimit social.

10. Terminalet dhe stacionet për hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve do të dizinfektohen çdo ditë nga bashkia përkatëse, në bashkëpunim me njësinë menaxhuese të terminalit/stacionit.

11. Në çdo mjet do të vendosen postera në vende të dukshme për udhëtarët për respektimin e

rregullave të higjienës, të rekomanduara nga OBSH-ja, MSHMS-ja dhe ISHP-së.

12. Subjektet e transportit të licencuara duhet të sigurojnë respektimin e masave të higjienës, distancimit social dhe rregullat për hipjen/zbritjen e udhëtarëve.

13. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

III. TRANSPORTI RRETHQYTETËS I UDHËTARËVE ME AUTOBUS

1. Numri i udhëtarëve që do të lejohen të udhëtojnë do të jetë 70% e kapacitetit të përcaktuar në lejen e qarkullimit, duke respektuar distancën e sigurisë midis udhëtarëve.

2. Ulja e udhëtarëve do të jetë në mënyrë diagonale. Kjo rregull do të zbatohet për të gjithë udhëtarët, përveçse kur personat janë pjesë e të njëjtës familjeje, vërtetuar/provuar në bazë të dokumenteve të identifikimit.

3. Udhëtarët duhet të jenë të pajisur me maska mbrojtëse, doreza, si dhe të respektojnë distancën e sigurisë.

4. Në stacionet e qëndrimit të respektohet masa e distancimit social.

5. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maskë mbrojtëse/doreza.

6. Mjetet e operimit do të dezinfektohen çdo ditë në ambiente të subjektit të licencuar nën monitorimin e bashkisë.

7. Mjetet e operimit duhet të pajisen me dezinfektantë me bazë alkooli dhe me shenja sinjalizuese për qëndrimin e udhëtarëve, duke respektuar masën e distancimit social.

8. Në çdo mjet do të vendosen postera për respektimin e rregullave të higjienës të rekomanduara nga OBSH-ja, MSHMS-ja dhe ISHP-ja, të vendosura në vende të dukshme për udhëtarët.

9. Gjatë udhëtimit duhet të bëhet e mundur ajrimi i ambienteve të brendshme të mjetit, duke mbajtur dritaret hapur, përgjatë gjithë kohës së udhëtimit.

10. Subjektet e transportit të licencuara duhet të sigurojnë respektimin e masave të higjienës, distancimit social dhe rregullat për hipjen/zbritjen e udhëtarëve.

11. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet



kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

IV. TRANSPORTI I RREGULLËS NDËRKOMBËTARE TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS ME NISJE NGA SHQIPËRIA

1. Numri i udhëtarëve që do të lejohen të udhëtojnë do të jetë 70% e kapacitetit të përcaktuar në lejen e qarkullimit, duke respektuar distancën e sigurisë midis udhëtarëve.

2. Ulja e udhëtarëve do të jetë në mënyrë diagonale. Kjo rregull do të zbatohet për të gjithë udhëtarët, përveçse kur personat janë pjesë e të njëjtës familjeje, vërtetuar/provuar në bazë të dokumenteve të identifikimit.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska mbrojtëse, doreza dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Udhëtarët duhet detyrimisht të mbajnë maska mbrojtëse dhe doreza përgjatë gjithë udhëtimit.

5. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në dyer të ndryshme të mjetit, të parashikuara për këtë qëllim.

6. Në nisje do të matet temperatura e çdo udhëtari nga subjekti transportues, duke mos lejuar personat të udhëtojnë që shfaqin temperaturë mbi 37.5 gradë. Nëse udhëtari shfaq simptomat e tjera të COVID-19, bazuar në rekomandimet e MSHMS dhe ISHP-së, subjekti transportues duhet të lajmërojë Urgjencën Kombëtare, në numrin e kontaktit 127.

7. Në pikat e kalimit kufitar do të ketë kontroll nga personeli mjekësor, ku çdo udhëtar do i nënshtrohet matjes së temperaturës dhe nëse shfaq simptoma nuk do të lejohet të udhëtojë, duke njoftuar organet kompetente.

8. Subjektet e licencuara të transportit, në nisje duhet të dezinfektojnë mjetet, bagazhet, si dhe të kenë dezinfektantë me bazë alkooli për tu përdorur nga udhëtarët në momentin e hipjes.

9. Mjetet duhet të kenë ajrim natyral dhe duhet të kryejnë ndalesa çdo 2–2.5 orë në vende të lejuara për ndalimin e tyre në territorin shqiptar dhe në territorin e vendit destinacion, sipas stacioneve të miratuara të cituara në autorizimin përkatës për shërbimin në linjë të rregullt ndërkombëtare ose shërbimet turistike. Përgjatë ndalesave duhet të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë që nuk janë pjesë e udhëtimit dhe kontakti të mos zgjasë më shumë se 15 sekonda.

10. Pas çdo ndalese duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.

11. Terminalët/stacionet e autobusëve të transportit ndërkombëtar, në linjë të rregullt duhet të dezinfektohen çdo ditë.

12. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi të vendit të origjinës dhe vendit destinacion.

V. TRANSPORT I RREGULLT NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE ME AUTOBUS, ME KALIM TRANZIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar duhet të respektojë rregullat e vendosura dhe t'u nënshtrohet kontrolleve nga shteti shqiptar.

2. Në pikat kufitare hyrëse, drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar do t'i nënshtrohen kontrollit nga personeli mjekësor dhe matjes së temperaturës. Nëse një person shfaq temperaturë mbi 37.5 gradë dhe simptoma të infeksionit COVID-19, nuk do të lejohet të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska mbrojtëse, doreza dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Udhëtarët duhet të mbajnë maska mbrojtëse dhe doreza përgjatë gjithë udhëtimit.

5. Mjeti duhet të ketë ajrim natyral dhe përgjatë ndalesave duhet të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë, që nuk janë pjesë e udhëtimit dhe kontakti të mos zgjasë më shumë se 15 sekonda.

6. Pas çdo ndalese duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.

7. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

VI. TRANSPORT I RREGULLT NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE ME AUTOBUS ME DESTINACION, DHE/OSE TRANZIT NË TERRITORIN SHQIPTAR.

1. Drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar duhet të respektojë rregullat e vendosura dhe t'u nënshtrohet kontrolleve nga shteti shqiptar.

2. Në pikat kufitare hyrëse, drejtuesi i mjetit dhe çdo udhëtar do t'i nënshtrohen kontrollit nga personeli mjekësor dhe matjes së temperaturës. Nëse një person shfaq temperaturë mbi 37.5 gradë



dhe simptoma të infeksionit COVID-19, nuk do të lejohet të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska mbrojtëse, doreza dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Udhëtarët duhet të mbajnë maska mbrojtëse dhe doreza përgjatë udhëtimit.

5. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në dyer të ndryshme të mjetit, të parashikuara për këtë qëllim.

6. Në pikat kufitare hyrëse duhet të dezinfektohet mjeti, bagazhet, si dhe përgjatë udhëtimit të ketë dezinfektantë me bazë alkooli për t'u përdorur nga udhëtarët.

7. Mjeti duhet të ketë ajrim natyral dhe duhet të kryejë ndalesa çdo 2–2.5 orë, në vende të lejuara për ndalimin e tyre. Përgjatë ndalesave duhet të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë, që nuk janë pjesë e udhëtimit dhe kontakti të mos zgjasë më shumë se 15 sekonda.

8. Pas çdo ndalese duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.

9. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

VII. TRANSPORTI I RASTIT – TURISTIK, BRENDA DHE JASHTË VENDIT, I UDHËTARËVE ME AUTOBUS, ME PIKËNISJE NGA SHQIPËRIA

1. Numri i udhëtarëve që do të lejohen të udhëtojnë do të jetë 70% e kapacitetit të mjetit të përcaktuar në lejen e qarkullimit, duke respektuar distancën e sigurisë midis udhëtarëve.

2. Ulja e udhëtarëve do të jetë në mënyrë diagonale. Kjo rregull do të zbatohet për të gjithë udhëtarët, përveçse kur personat janë pjesë e së njëjtës familjeje, vërtetuar/provuar në bazë të dokumenteve të identifikimit.

3. Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me maska mbrojtëse, doreza dhe të kontrollojë respektimin e masave në mjet.

4. Pasagjerët duhet detyrimisht të mbajnë maska mbrojtëse dhe doreza përgjatë udhëtimit.

5. Hipja dhe zbritja e udhëtarëve duhet të bëhet në pika të ndryshme të mjetit.

6. Në nisje do të matet temperatura e çdo udhëtari nga subjekti transportues, duke mos lejuar personat udhëtojnë që shfaqin temperaturë mbi 37.5 gradë. Nëse udhëtari shfaq simptomat e tjera

të COVID-19 bazuar në rekomandimet e OBSH-së, MSHMS-së dhe ISHP-së, subjekti transportues duhet të lajmërojë Urgjencën Kombëtare, në numrin e kontaktit 127.

7. Në pikat e kalimit kufitar do të ketë kontroll nga personeli mjekësor, ku çdo pasagjer do t'i nënshtrohet matjes së temperaturës dhe nëse shfaq simptoma nuk do të lejohet të udhëtojë, duke njoftuar organet kompetente.

8. Shoqëria e transportit në nisje duhet të dezinfektojë mjetin, bagazhet, si dhe të ketë dezinfektantë me bazë alkooli për t'u përdorur nga udhëtarët në momentin e hipjes.

9. Në çdo mjet do të vendosen postera në vende të dukshme për udhëtarët, për respektimin e rregullave të higjienës të rekomanduara nga OBSH-ja, MSHMS-ja dhe ISHP-ja.

10. Mjeti duhet të ketë ajrim natyral dhe duhet të kryejë ndalesa çdo 2 orë. Përgjatë ndalesave duhet të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë që nuk janë pjesë e udhëtimit dhe kontakti të mos zgjasë më shumë se 15 sekonda.

11. Pas çdo ndalese duhet të kryhet domosdoshmërisht dezinfektimi i duarve.

12. Terminalët e autobusëve të transportit ndërkombëtar të rregullt duhet të dezinfektohen çdo ditë.

13. Masat e parashikuara në protokollin e sigurisë janë objekt kontrolli nga organet kompetente të parashikuara me aktet ligjore në fuqi.

VIII. TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR RRUGOR I MALLRAVE

1. Mjetet dhe kabina e drejtuesit të mjetit duhet të dezinfektohen çdo ditë.

2. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me maska, doreza dhe dezinfektantë me bazë alkooli.

3. Në pikat kufitare drejtuesi i mjetit dhe punonjësit shoqërues do t'i nënshtrohen kontrollit dhe matjes së temperaturës nga personeli mjekësor. Nëse një person i angazhuar në kryerjen e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, shfaq temperaturë mbi 37.5 gradë dhe simptoma të infeksionit COVID-19, nuk do të lejohet të hyjë në territorin shqiptar ose të dalë.

4. Nuk lejohet hipja e personave të paautorizuar në mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar mallrash.

5. Ngarkimi dhe shkarkimi i mallrave duhet të kryhet nga personi i autorizuar nga subjekti dhe



drejtuesi i mjetit nuk duhet të përfshihet në këtë proces.

6. Çdo drejtues mjeti dhe punonjës i përfshirë në transport të informohet mbi rrezikun e situatës, masat e marra në nivel kombëtar dhe masat e marra nga subjekti, i cili gjithashtu, duhet të informojë punonjësit mbi numrat e kontaktit të autoriteteve shëndetësore dhe të nxisë komunikimin elektronik midis punonjësve.

7. Të shmanget sa më shumë përdorimi i pagesave *cash* dhe të kalohet nëpërmjet kryerjes së pagesave elektronike.

8. Drejtuesi i mjetit të eliminojë ndalesat në vendet me shumë njerëz. Përgjatë ndalesave duhet të përdoren mjete mbrojtëse, të shmanget maksimalisht kontakti me personat e tjerë që nuk janë pjesë e udhëtimit dhe kontakti të mos zgjasë më shumë se 15 sekonda. Ushqimi rekomandohet të merret me vete dhe të konsumohet brenda në kabinën e mjetit, sesa të hahet në vendet pushimi.

9. Drejtuesi i mjetit duhet të ventilojë/ajrosë rregullisht kabinën e mjetit në pikat/vendet e pushimit.

10. Agjentët doganorë të kryejnë aktivitetin e tyre, në përputhje me rregullat e higjienës dhe të distancimit social, të lejojnë vetëm 1 person në zyrë ose maksimumi 2, të ruajnë distancën prej 1.5m, të kryejnë dezinfektimin e dokumenteve etj.

11. Të kryhet dezinfektimi çdo 24 orë i terminaleve/vendeve të qëndrimit/parkimit të transportit rrugor të mallrave.

C. MENAXHIMI I OPERIMEVE NË PORTET E HAPURA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Protokolli ka qellim të ndihmojë në ruajtjen dhe në mbrojtjen e shëndetit të punonjësve të terminaleve, operatorëve të portit, ekuipazheve dhe pasagjerëve, si dhe për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së COVID-19 në portet e hapura në Republikën e Shqipërisë.

1. FUSHA E VEPRIMIT

Protokolli do të zbatohet nga autoritetet portuale, operatorët portualë, pilotët, agjentët, stivadorët, stafin tjetër të portit, pasagjerët dhe ekuipazhin gjatë kryerjes së operacioneve të pilotimit, akostim/çakostim, ngarkimit dhe shkarkimit të anijeve, transportit të pasagjerëve gjatë kohëzgjatjes së Pandemisë COVID-19.

2. KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Marrja e masave organizative dhe rregullave të hollësishme për kontrollin e epidemisë COVID-19, kontrollin rigoroz të pasagjerëve dhe të ekuipazheve, funksionimin e portit, aktiviteteve operacionale, shëndetin në punë dhe të parandalimit përhapjes së COVID-19. Shkëmbimi i informacionit, izolimi në anije-port, kontrolli i hyrjes, ventilimi dhe dezinfektimi, pajisjet e mbrojtjes personale, trajtim urgjent dhe parandalimi i rrezikut të rasteve të importuara të COVID-19.

3. MENAXHIMI I INFORMACIONIT DHE RAPORTIMI

1. Informacione në mbërritje për anijet dhe ekuipazhin e tyre

Sigurimi i shkëmbimit të informacionit me agjentët e anijeve, doganat dhe administratat detare dhe institucione të tjera, dhe formulimi i planeve të punës përkatëse, bazuar në informacionin e mëposhtëm të anijeve dhe ekuipazhit:

1.1 Informacione në lidhje me portet e thirrjeve, oraret e mbërritjes dhe të nisjes.

1.2 Informacione rreth ekuipazhit, pasagjerëve, kushteve të tyre shëndetësore, informacioneve përfshirë ndërrimin e ekuipazhit, personeli që imbarkohet dhe zbarkohet, furnizimet e anijeve dhe personeli i kontaktit.

1.3 Informacione rreth karantinës së anijeve, masave parandaluese.

1.4 Informacione në lidhje me kontaktet e afërt të ekuipazhit gjatë akostimit.

1.5 Informacioni i trajtimit në lidhje me ujërat e zeza dhe ujërat e ballasteve.

2. Paraqitja e informacionit

Raportimi për çdo 24 orë në njësinë epidemiologjike të portit për parandalimin dhe kontrollin, sipas kërkesave përkatëse.

4. PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT

1. Grupi i kontrollit i përbërë nga mjeku, përfaqësues të Kapitenarisë, doganës dhe policisë organizon dhe mban një takim para se një anije të hyjë në port për të vlerësuar rrezikun, në lidhje me parandalimin dhe kontrollin epidemisë, për të sqaruar masat specifike parandaluese dhe masat paraprake të punonjësve përkatës, dhe caktimin e personit përgjegjës për këtë çështje.

2. Autoriteti Portual/porti, përmes agjencisë së anijeve dhe njësisë epidemiologjike, nxit anijet që të kryejnë dezinfektimin, ventilimin dhe punët e tjera



të lidhura, personelin që kanë në detyrë gjatë kësaj periudhe, regjistrimin me saktësi të informacionit të identitetit të personave që imbarkojnë dhe zbarkojnë, arsyet e tyre për të hipur apo zbritur nga anija dhe personin e kontaktit.

3. Anijet e angazhuara në udhëtime ndërkombëtare mund të kryejnë operacionet e ngarkimit dhe të shkarkimit pas përfundimit të kontrollit nga doktori i portit për simptomat epidemiologjike në të cilën rezulton se ekuipazhi është i shëndetshëm.

4. Përcaktimi i masave të rrepta për shmangien e kontakteve direkte midis personelit në anije dhe atyre në tokë. Plani i sigurisë së facilitetit portual zbatohet plotësisht në port. Forcimi i menaxhimit i procedurave të imbarkimit dhe të zbarkimit, duke zbatuar protokollet shitesë të parandalimit dhe kontrollit të COVID-19. Kontroll i rreptësishëm i komunikimit anije-tokë. Anëtarët e ekuipazhit nuk iu rekomandohet të zbresin nëse nuk është tepër e nevojshme.

5. Agjencia e transportit dhe njësi të tjera portuale bëjnë njoftimin paraprak për personat dhe automjetet që hyjnë dhe dalin nga porti për kontrollin e temperaturës i cili do të kryhet rreptësisht përpara futjes në terminale dhe ambiente të mbyllura. Personat, trupi i të cilëve tejkalon temperaturë 37.5°C janë rreptësisht të ndaluar për të hyrë në port, dhe duhet të jetë raportuar në njësinë epidemiologjike sipas procedurave.

5. KËRKESAT PËR AUTORITETIN PORTUAL/PORTIN

1. Pajisjet për kontrollin e temperaturës së trupit sigurohen në hyrje të vendit të punës dhe zonat e punës. Pajisjet e nevojshme mbrojtëse, si: maska, doreza, syze dhe materialet e tjera shërbejnë për operatorët dhe sigurohen udhëzimet e duhura për përdorimin e tyre sipas nivelit të rrezikut dhe pozicioneve të tyre të punës.

2. Autoriteti Portual/Porti do të rrisë rezervën dhe furnizimin me materiale antiepidemike, sigurimin e maskave mjekësore, dorezave, syzeve, veshjeve mbrojtëse, termometra infra të kuqe, dhe dezinfektues etj.

3. Monitorimi shëndetësor i portit do të forcohet dhe sistemi i raportimit të përditshëm do të vendoset periodikisht.

4. Personeli do të furnizohet në mënyrë të duhur dhe përparësi me materiale mbrojtëse

antiepidemike, produkte dezinfektimi dhe sterilizimi dhe të ngjashme. Blerja, konfigurimi dhe përdorimi i të gjitha pajisjet mbrojtëse për punonjësit e linjës së parë do të jetë parësore, për shkak të rrezikut të lartë.

5. Materialet e parandalimit të epidemisë përfshijnë, por nuk kufizohen, në: maska të zakonshme, mjekësore maska mbrojtëse të nivelit të lartë, veshje mbrojtëse, syze mbrojtëse ose ekrane mbrojtëse të fytyrës, dezinfektues (klor-antiseptik nga 250 mg/L deri 500 mg/L dezinfektues i klorit ose 75% alkool, i cili nuk duhet të përzihet në përdorim dhe në depo), dorezat e disponueshme, dorezat e gomës, termometrat infra të kuqe, automjete të urgjencës, medikamente të urgjencës.

6. KËRKESAT PARANDALUESE PËR OPERATORËT PORTUALË

1. Kërkesat e mbrojtjes për operatorët e terminalëve

1.1 Kontrolli i temperaturës së trupit dhe dokumentimi i kontakteve të afërta të personelit të operatorit portual me ekuipazhin e anijes.

1.2 Asnjë operator në terminal nuk lejohet të hipë në anije ose të kontaktojë drejtpërdrejt me ekuipazhin. Nëse nuk është tepër e nevojshme për punë, personeli duhet të mbajë në një distancë të sigurt prej rreth një metër e gjysmë dhe me masat e vetëmbrojtjes.

1.3 Njoftimet dhe informacione paralajmëruese për mbrojtjen dhe parandalimin e COVID-19 do të publikohen gjatë operacioneve portuale. Nga ekuipazhi kërkohet të veshin maskë, doreza, hi gjene personale dhe mbajtja e një distance prej 1 metri e gjysmë, nëse është e nevojshme që të punohet me punonjësit e terminalit së bashku. Të gjitha ekuipazhet që duhet të punojnë në tokë duhet të kenë kontrolluar temperaturat e trupit të tyre.

1.4 Videokonferenca, *Webchat* dhe rrjete sociale këshillohet të përdoren për komunikim, duke shmangur mbledhjen e stafit.

2. Kërkesat parandaluese për pilotët.

2.1 Pilotët, automjetet për transferimin e pilotëve, anijet pilot duhet të jenë duhet të jenë të pandryshuara dhe të kryhet monitorimi i temperaturës trupore periodikisht.

2.2 Gjatë pilotimit, piloti duhet të mbajë higjienën personale, të veshë veshje mbrojtëse,



syze, maska, doreza apo pajisje të tjera mbrojtëse personale në mënyrë korrekte gjatë gjithë procesit.

2.3 Gjatë hipjes dhe zbarkimit të anijes, pilotët duhet të zgjedhin sa të jetë e mundur shkallët dhe korridoret jashtë akomodimit për të shmangur zonën e banimit të ekuipazhit.

2.4 Gjatë pilotimit, duhet të njoftohet për të kontrolluar numrin e ekuipazhit në urën e komandimit dhe ura duhet të jetë e ajrosur mirë. Piloti duhet të zvogëlojë ose të shmangë kontaktin me të ekuipazhit, dhe të mbajë një distancë të sigurt fizike. Nëse kushtet e lejojnë, pajisjet e specializuara të komunikimit të tilla si bisedat *Walkie-Talkie* duhet të përdoren për të shmangur kontaktin me ekuipazhin.

2.5 Piloti duhet të përpiqet të shmangë ushqimin dhe përdorimin e tualetit në bord.

2.6 Piloti duhet të marrë masa dezinfektimi, në përputhje me rregulloret e zbarkimit nga anija. Artikuj të mbeturinave, siç janë pajisjet mbrojtëse të disponueshme duhet të mbliken dhe përpunohen në përputhje me rregulloret.

2.7 Dretuesit e automjetit që po transferon pilotin dhe ekuipazhin e anijes pilot duhet të veshin maska, doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse personale në mënyrë korrekte dhe kontrolli i temperaturës së trupit të tyre do të kryhet rregullisht.

3. Kërkesat e mbrojtjes për personelin tjetër në anije

3.1 Personeli që hip në anije do të ketë maska, doreza, syze dhe pajisje mbrojtëse personale të tjera dhe temperatura e trupit të tyre do të jetë e kontrolluar dhe regjistruar.

3.2 I gjithë personeli që hip në anije është i ndaluar të hyjë në zonën e banimit të ekuipazhit dhe duhet mos kontaktojë direkt ekuipazhin. Nëse është jashtëzakonisht e nevojshme, personeli duhet të punojë në një zonë e hapur dhe të ruajë distancën e sigurt për më shumë se 1 metër e gjysmë.

3.3 Personeli që hip në anije duhet të përpiqet të shmangë ushqimin, përdorimin e tualetit dhe ambientet e pushimit në bord. Pasi të përfundojë puna, personeli duhet të largohet nga anija sa më shpejt të jetë e mundur.

3.4 Personeli që hip në anije duhet të marrë masa dezinfektimi, në përputhje me rregulloret. Artikujt e mbeturinave, siç janë pajisjet mbrojtëse

të disponueshme duhet të jenë mbledhur dhe përpunuar në përputhje me rregulloret.

7. MBROJTA EPIDEMIKE

1. Kërkesat e ventilimit dhe e ajrimit në mjedis

1.1 Ventilimi mjedisor do të forcohet. Sallat e pritjes, mensa, salla konferencash, zona zyrash dhe hapësira të tjera duhet të jenë të pajisura me alkool dhe furnizime të tjera dezinfektuese dhe dritaret e tyre duhet të hapen rregullisht për ventilim, për të ruajtur qarkullimin e ajrit të brendshëm jo më pak se 3 herë në ditë dhe jo më pak se 30 minuta çdo herë.

1.2 Kondicionerët do të përdoren siç duhet. Preferohet ventilimi natyral.

1.3 Rrethinat duhet të mbahen të pastra dhe të rregullta. Mbeturinat do të pastrohen dhe do të transportohen në kohë.

2. Pastrimi dhe dezinfektimi.

2.1 Automjetet dhe anijet për transferimin e stafit do të dezinfektohen çdo herë.

2.2 Sipërfaqet e objekteve që shpesh kontaktohen (dritaret e pritjes, butonat e ashensorit, parmakët, dorezat e dyerve etj.) do të spërkatën ose fshihen me përmbajtje dezinfektuese të klorit, klor efektiv 250 mg/L ~ 500 mg/L ose fshihen me peshqirë të lagësht dezinfektues.

2.3 Zonat e mbledhjes së personelit (të tilla si: salla e pritjes, zona e zyrës, banja etj.) do të pastrohen dhe do të dezinfektohen të paktën dy herë në ditë në interval të rregullt. Këto zona do të spërkatën me dezinfektues që përmban klor (duke përdorur dezinfektues në një raport prej jo më pak se 1:50) për të siguruar që dezinfektimi përqendrimi është 20–30 ml për metër kub ose do të fshihet me dezinfektim në një përqendrim prej jo më pak se 75% alkool për pajisjet e lidhura dhe zonat që preken nga shumë njerëz. Asnjëherë nuk do të përdoret një përzierje të dezinfektuesve që përmbajnë klor dhe dezinfektues të alkoolit.

2.4 Zonat do të mbahen relativisht të mbyllura për të arritur efektin e dezinfektimit gjatë spërkatjes me dezinfektuesit. Dritaret nuk do të hapet deri 20 minuta më vonë nga spërkatja e dezinfektuesit për të mbajtur përsëri ventilimin natyral. Këto zona mund të rifillojnë duke punuar normal pas të paktën 10 minutash.

2.5 Kontejnerët e plehrave, siç janë koshat e plehrave do të pastrohen më shpesh dhe dezinfektohen rregullisht. Këto enë mbeturinash mund të spërkatën me një dezinfektues që



përmban klor, që përmban 250 mg/L deri 500 mg/L, ose të fshihen me peshqir të lagësht të dezinfektuar.

3. Mbrojtja e higjienës

3.1 Një ose dy pika kontrolli të temperaturës së trupit pa kontakt do të vendosen në hyrjet dhe në daljet. Kur kryhet kontrolli i temperaturës së trupit, personeli do të përpiqet të mbajë distancën më shumë se 1 metër e gjysmë nga personi i kontrolluar, duke veshur rroba pune, mbrojtëse maska, doreza të disponueshme ose doreza gome dhe nëse është e mundur syze mbrojtëse.

3.2 Disa punëtorë operativë, vizitorë, personel biznesi që duhet të hyjnë në të zonat e punës do të veshin maska mbrojtëse, nuk do të kenë kontaktin fizik, siç janë shtrëngimi i duarve dhe përqaftimi, si dhe do të mbajnë higjienë personale.

3.3 Zona e mbledhjes së personelit do të jetë e ndarë në një distancë të arsyeshme.

3.4 Të gjithë pjesëmarrësit do të veshin maska mbrojtës në distance më shumë se 1 metër e gjysmë. Koha e takimit duhet të kontrollohet dhe dritaret mbahen të hapura nëse koha e takimit të jetë shumë e gjatë. Vendi i takimit, mobilet, furnizimet duhet të dezinfektohen pasi të jenë përfunduar.

3.5 Do të shmangen mbledhjet e personelit për ngrënien. Ambientet e ushqimit do të dezinfektohen çdo herë para dhe pas përdorimit. I gjithë personeli do të veshë maska mbrojtëse duke shmangur kontaktin fizik dhe duke larë duart shpesh. Do të përdoren produkte të dezinfektimit të bazuara në alkool (siç është zgjidhja 75% e alkoolit) për të duar të pastra nëse nuk ka ujë të pastër.

3.6 Do të përdoret peshqir të lagësht për dezinfektim për të fshirë dorezat e dyerve, telefonat, tastierat, dhe çdo vend tjetër kontakti.

3.7 Përveç inspektimit ditor të sigurisë dhe funksionimit të mallrave të rrezikshëm, do t'u kushtohet vëmendje rreziqeve elektrostاتيke që mund të shkaktohen nga veshja mjeteve mbrojtëse (nëse ka). Procedurat e eliminimit statik do të kryhen kur kryen hyrje në zonat e operimit të mallrave të rrezikshme.

3. Terminali i pasagjerëve duhet të zbatojë parandalimin dhe kontrollin, në përputhje me protokollet mbi COVID-19, "Parandalimin dhe kontrollin epidemik në pasagjerë, terminalet me kategori të ndryshme rreziku".

8. PLANIFIKIMI I DUHUR I URGJENCËS

1. Autoriteti Portual/porti do të krijojë dhe do të përmirësojë planet e emergjencës, duke përmirësuar kushtet e karantinës ekzistuese, si sistemi ventilimit dhe rinovimi i ambienteve me kushte të mira dhe sipas kriterëve. Transferimin e karantinës në një kat nëntokë, duke e përshtatur me situatën e re të shkaktuar nga COVID-19 dhe situata të ngjashme në të ardhmen për lehtësimin e transportit të pacientëve.

2. Do të kryhet bashkëpunim intensiv midis departamenteve, degëve doganore, policisë kufitare dhe emigracionit, si dhe administratës detare për shkëmbimin e informacionit me shëndetësinë lokale, transportin dhe të tjera departamente. Në rast se do të rezultojë pacient i dyshimtë me shenja të sëmundjeve që mund të përhapin infeksione dhe epidemi do të kryhen procedura, sipas udhëzimeve të MSHMS-së, ISHP-së dhe OBSH-së, të cilat janë të përcaktuara mirë, sipas kësaj skemës operimit në vijim. Sektori i mbrojtjes epidemiologjike merr pacientin, transporton atë në ambientet e karantinës. Pas kryerjes dhe marrja e anamnezës dhe vizita mjekësore nga personeli, bëhet izolimi i tij në karantinë dhe njoftohen strukturat, si: shefi i Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive në ISHP Tiranë, shefin e NJVKSH-së Rajonale dhe shefin e Repartit Infektiv Rajonal për kryerjen e testit COVID-19 dhe ndjekjen e procedurave në vazhdimësi.

3. Nëse dikush nga ekuipazhi gjenden me ethe, kollitje dhe kushte të tjera anormale shëndetësore anijes i kërkohet të ventilojë dhe dezinfektohet dhe të gjithë anëtarët e ekuipazhit duhet të veshin maska mbrojtëse të nivelit të lartë, izolimi i personelit dhe masa të tjera parandaluese. Në të njëjtën kohë, autoritetet e portit/porti do të miratojnë masa të rrepta të izolimit të tyre, do të bashkëpunojnë me departamentet përkatëse për t'u marrë me hetimin dhe më izolimin e kontakteve të ngushta personeli i njëjësive të tyre.

4. Kur një person është gjetur me të vjella me simptoma të rastit të dyshuar COVID-19, të vjellat do të mbulohen dhe do të dezinfektohen menjëherë me një sasi të mjaftueshme të dezinfektues (siç është dezinfektuesi që përmban klor) ose një dezinfektues efektiv i thatë peshqir me materiale absorbuese të disponueshme. Pasi të jenë hequr të vjellat, dezinfektuesit që përmbajnë klor



do të përdoren për dezinfektimin e sipërfaqes së objektit.

5. Pas izolimit të personit të dyshuar të infektuar, do të dezinfektohen plotësisht dhoma e kujdesit të përkohshëm dhe zonat e tjera që mund të jenë të kontaminuara. Anijet dhe automjetet e përdorura për transferimin e personave të dyshuar të infektuar do të dezinfektohet plotësisht pasi transferimi të ketë përfunduar.

9. KËRKESAT PËR MJETET DETARE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE DHE TERMINALET E DEDIKUARA PËR OPERIMIN E NJERËZVE DHE TË MJETEVE NË PORT

1. Kërkesat për mjetet detare të transportit të udhëtarëve

1.1 Mjetet detare të transportit të pasagjerëve lejohen të mbajnë deri në 70% të kapacitetit të tyre maksimal të pasagjerëve të përcaktuar me legjislacionin aktual, në varësi riskut të përhapjes së infeksionit.

1.2 Mjetet detare të transportit të pasagjerëve që kanë kabina lejohen të transportojnë deri në 80% të aftësisë së tyre origjinale të akomodimit të pasagjerëve, në varësi të riskut të përhapjes së infeksionit.

1.3 Pasagjerët duhet të mbajnë një distancë prej 1.5 metrash ndërmjet njëri-tjetrit gjatë hipjes, zbarkimit dhe në të gjitha zonat e anijes.

1.4 Vetëm një pasagjer të lejohet për kabinën, përveç kur pasagjerët janë të së njëjtës familjeje.

1.5 Personat me nevoja të veçanta t'u lejohet shoqërimi nga një person tjetër.

1.6 Maskat janë të detyrueshme të mbahen nga pasagjerët dhe anëtarët e ekuipazhit.

1.7 Mjetet detare të transportit të pasagjerëve që ofrojnë ndenjësë për pasagjerët në salla të dedikuara të përcaktohet ulja e udhëtarëve, në një mënyrë e cila ruan distancën midis udhëtarëve.

1.8 Mjetet detare të transportit të pasagjerëve duhet të kenë spote informative dhe të luajnë mesazhe audio në foninë e anijeve.

1.9 Ekuipazhi në mjetet detare të transportit të pasagjerëve do t'u nënshtrohen trajnimeve specifike lidhur me zbatimin e protokollove.

1.10 Rregulla të veçanta të higjienës personale do të zbatohen nga të gjithë pasagjerët.

1.11 Të gjitha mjetet detare të transportit të pasagjerëve do të kenë stacione dezinfektimi në zona të ndryshme.

1.12 Mjetet detare të transportit të pasagjerëve do të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht.

1.13 Mjetet detare të transportit të pasagjerëve do të sigurojnë ventilim dhe ajër të kondicionuar.

1.14 Rregulla të veçanta do të zbatohen për administrimin e duhur të një rasti të dyshuar COVID-19 (izolimi në një zonë të veçantë, zbarkimi në portin tjetër, i cili ka aftësinë e nevojshme për administrimin e çështjes, përcjelljen e kontakteve të pacientit etj.).

1.15 Rregullat speciale do të zbatohen në të gjitha pikat e shërbimit të pasagjerëve (bare, restorante, dhoma ngrënie) të mjeteve detare të transportit të pasagjerëve.

2. Masat e kontrollit terminalet e dedikuara për operimin të pasagjerëve në port

2.1 Para imbarkimit në mjetet detare të transportit, pasagjerët janë të detyruar të dorëzojnë një pyetësor të gjendjes shëndetësore të mbushur më parë (të disponoheshe në sportele të portit ose mund të shkarkohet nga faqja *web*, gjatë imbarkimit së bashku me biletën).

2.2 Ekzaminimi me kamera termike në distancë nga monitorë të kontrolluar dhe specialistë të trajnuar të aplikohet në terminale për të gjithë pasagjerët që hyjnë në mjetet detare të transportit të pasagjerëve.

2.3 Pasagjerët duhet të mbajnë një distancë prej 1.5 metrash ndërmjet njëri-tjetrit gjatë hipjes, zbarkimit dhe në të gjitha zonat e terminalit.

2.4 Personat me nevoja të veçanta t'u lejohet shoqërimi nga një person tjetër.

2.5 Maskat janë të detyrueshme të mbahen nga pasagjerët dhe operatorët.

2.6 Lëvizja e pasagjerëve nga terminali në drejtim të mjetit detar të transportit të pasagjerëve dhe anasjelltas të bëhet në linja të kufizuara dhe të shënuara me distancën 1.5 metër nga njëra-tjetra.

2.7 Terminalet e pasagjerëve që ofrojnë ndenjësë për pasagjerët në salla të dedikuara të përcaktohet ulja e udhëtarëve në një mënyrë e cila ruan distancën midis udhëtarëve.

2.8 Shenjat e veçanta do të tregojnë se ku një pasagjer i lejohet të ulet.

2.9 Ekzaminimi i temperaturës me kamera termike në distancë nga monitorë të kontrolluar dhe specialistë të trajnuar, të aplikohet për të gjithë pasagjerët në hyrje të terminalit gjatë imbarkimit dhe para pikave të kontrollit të terminalit gjatë zbarkimit.



2.10 Një broshurë e shtypur me instruksione nga organi shëndetësor publik, duke shpjeguar masat, duhet t'u jepet të gjithë pasagjerëve.

2.11 Terminalët e pasagjerëve duhet të ketë spote informative dhe luajnë mesazhe audio në foninë e terminalit.

2.12 Punonjësit e terminaleve të pasagjerëve do t'u nënshtrohen trajnimeve specifike lidhur me zbatimin e udhëzimeve.

2.13 Rregulla të veçanta të higjienës personale do të zbatohen nga të gjithë pasagjerët.

2.14 Terminalët e transportit të pasagjerëve do të kenë stacione dezinfektimi në zona të ndryshme.

2.15 Terminalët e transportit të pasagjerëve do të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht.

2.16 Terminalët e transportit të pasagjerëve do të sigurojnë ventilim dhe ajër të kondicionuar.

2.17 Rregulla të veçanta do të zbatohen për administrimin e duhur të një rasti të dyshuar

COVID-19 (izolimi në një zonë të veçantë, zbarkimi në portin tjetër, i cili ka aftësinë e nevojshme për administrimin e çështjes, përcjelljen e kontakteve të pacientit etj.).

2.18 Rregullat speciale do të zbatohen në të gjitha pikat e shërbimit të pasagjerëve (bare, restorante, dhoma ngrënie) në terminalët e transportit të pasagjerëve.

Këto masa do të ndiqen edhe për jahte private që vijnë nga jashtë pas heqjes së kufizimeve.

10. PËRGJEGJËSIA

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe shtojcave përkatëse, Drejtoria e Përgjithshme Detare, autoritetet portuale/drejtuesit e porteve, drejtoritë rajonale për kufirin dhe migracionin dhe degët doganore në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë.

**PROTOKOLL**

PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E COVID-19, NË TERMINALET E PASAGJERËVE NË PORTET DETARE,
SIPAS KATEGORIVE TË NDRYSHME TË RREZIKUT

Titujt			Zonë rreziku i lartë (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i mesëm (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i ulët (frekuenca të dezinfektim)	Vërejte (vo)
Ventilimi Ajrosja	Terminali i pasagjerëve	Intervali i ventilimit/ajrosjes të hapësirave publike në të gjithë terminalin	Mbani ventilim për ajrosjen	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Mënyra natyrale përdoret për ventilim dhe koha e ventilimit është ≥ 10 minuta çdo herë; sipas kushteve të temperaturave të ajrit, ajri i kondicionerit mund të jetë fikur dhe dritaret duhet të jënë të hapura gjithë ditën për ventilim
Organizimi i transportit	Terminali i pasagjerëve	Shkalla e udhëtarëve të mbledhur krahasuar me numrin maksimal të udhëtarëve të parashikuar	$\leq 50\%$	$\leq 70\%$	$\leq 90\%$	Nëse një pasagjer ka temperature të trupit mbi 37.3 ose ka simptoma të COVID-19, stafi duhet menjëherë për ta transferuar pasagjerin në departamentin e shëndetësisë lokale
Dezinfektimi	Terminali i pasagjerëve	Terminali i pasagjerëve: pajisje për kontrollin e bagazheve, pajisja e <i>check-in-it</i> së biletave, tualetet, sallë pritjeje, objektet dhe pajisje të arritshme, shkallët, parrakë, banakë e të tjera	Çdo një orë	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Në rast konstatimi personi simptoma, menjëherë dezinfektoni zonën dhe objektet e kontaktit
		Zonat e kontaktit të pasagjerëve: hyrje të mbyllura, banakët e shitjes së biletave, terminali nga ana e detit (akostimit), pikat e kontrollit pasaportave, sallat e pritjes, tualetet, pikat e kontrollit të bagazheve zyra, zyra shërbimi të specializuara dhe restorante e dyqane	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Çdo gjashtë orë	



Titujt			Zonë rreziku i lartë (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i mesëm (frekuenca të dezinfektim)	Zonë rreziku i ulët (frekuenca të dezinfektim)	Vërejte (vo)
Dezinfektimi	Terminali i pasagjerëve	Zonat e kontaktit të stafit: Zyrat e personelit të operatorit portual, salla e pritjes, zyrat e doganë, polici, FSPD	Çdo dy orë	Çdo katër orë	Çdo gjashtë orë	
		Pastrimi dhe dezinfektimi i duarve në banjë	E pajisur	E pajisur	E pajisur	
Mbrojtje personale	Terminali i pasagjerëve	Shkalla e mbrojtës personale e udhëtarëve, duke mbajtur maska	100%	100%	100%	
		Shkalla e kontrollit të temperaturës së trupit të pasagjerit	100%	100%	100%	
		Shkalla e stafit të veshur maska mbrojtëse	100%	100%	100%	
		Kërkesat për kontrollin e temperaturës së trupit të stafit	Çdo katër orë	Çdo gjashtë orë	Çdo herë që merr dhe lë punën	
		Kërkesat për zonat e vëzhgimit të përkohshëm	Të gjithë pasagjerët në terminal	Të gjithë pasagjerët në terminal	N/A	
		Zonat e pirjes së duhanit (nëse ka)	Mbyllur	Mbyllur	N/A	
Reklamë	Passenger terminal	Publikimi dhe njoftimi për mbrojtjen e shëndetit përmes radios, videos, posterave etj.	Në vazhdimësi	Në vazhdimësi	Në vazhdimësi	



VENDIM
Nr. 94, datë 8.6.2020

**MBI ÇMIMIN E APLIKUESHËM PËR
PRODHUESIT EKZISTUES ME
PËRPARËSI, PËR VITIN 2020, NË
ZBATIM TË NDRYSHIMEVE TË
MIRATUARA ME VKM-në NR. 396,
DATË 13.5.2020**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi’”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 64/2 prot., datë 3.6.2020, përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 7, datë 16.1.2020, ka vendosur “Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike prej 8.0532 lekë/kWh, i cili do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, për vitin 2020”.

- Në vijim, me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, janë miratuar disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, ku përcaktohet se:

- në pikën 3, të vendimit nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, fjalët: “... në masën 1.30 ...” zëvendësohen me: “... në masën 1.20 ...”;

- ngarkohet ERE për përcaktimin e çmimit të aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- VKM-ja nr. 396, datë 13.5.2020, ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 88, datë 18.5.2020.

- Në zbatim të pikës 1, të VKM-së nr. 396, datë 13.5.2020, formula e llogaritjes së çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, miratuar me VKM-në nr. 687, datë 22.11.2017, ndryshon si më poshtë vijon:

- Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.20 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) është marrë çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2019, i cili rezulton në vlerën 50.36 euro/MWh, sipas tabelës më poshtë:

Description	2018	2019
HUPX Base Average Price (EUR/MWh)*	51,00	50,36

- Bonusi për promovimin e burimeve të rinovueshme është përcaktuar në masën 1.20, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 396, datë 13.5.2020, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi’”.

- Nga të dhënat e deritanishme, të publikuara nga Banka e Shqipërisë, mbi kursin e këmbimit euro/lekë për çdo ditë të vitit 2019, rezulton që kursi mesatar ditor i këmbimit për vitin 2019 të ketë qenë 122.9978 euro/lekë.

- Nisur nga elementët e përcaktuar sa më sipër dhe në zbatim të formulës llogaritëse të pikës 3, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, “Mbi metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të ndryshuar, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, llogaritet si më poshtë:

- $Pu = 50.36 / 1000 * 1.2 * 122.9978 = 7.433$ lekë/kWh.



- Ndërkohë, në germën “ç” dhe “d”, të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, përcaktohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike, nga prodhuesit ekzistues me përparësi, të cilët janë përkatësisht: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016. Çmimi i miratuar për vitin 2016, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.2.2016, është 7,448 lekë/kWh.

Duke qenë se, çmimi i llogaritur sipas formulës së përcaktuar në metodologjinë e miratuar me VKM-në nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, rezulton nën kufirin minimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike, të përcaktuar në germën “ç”, të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, çmimi i aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, do të jetë 7.448 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Çmimi i aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020, të jetë 7.448 lekë/kWh.

2. Ky vendim i shtrin efektet nga hyrja në fuqi e deri në datën 31.12.2020.

3. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019, në rast se kursi i këmbimit lekë/EUR do të rezultojë i ndryshëm nga vlera e publikuar deri në marrjen e këtij vendimi, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, i cili do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2020.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi i Bordit të ERE-s nr. 7, datë 16.1.2020, shfuqizohet.

5. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë